# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5481
E hënë, 21 maj 2018
çmimi 0.40 €

## A do të ulen pagat në Telekomin e Kosovës?

FAQE 9



Brenda këtij jave Bordi i Telekomit të Kosovës pritet të dalë me një plan të ristrukturimit të kësaj ndërmarrje, në të cilin parashihen edhe masat emergjente që duhen të ndërmerren për shpëtimin nga falimentimi

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de



DEPUTETËT E PARTIVE NË PUSHTET E KOMENTOJNË KËRKESËN E OPOZITËS PËR ZGJEDHJE TË REJA FAQE 4-5

# Kërkesa e opozitës për zgjedhje të reja, përpjekje joserioze

Kërkesa e opozitës për zgjedhje të reja nga deputetët e partive në pushtet nuk po konsiderohet përpjekje serioze. Zenun Pajaziti dhe Blerim Kuçi kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se zgjedhjet parlamentare e kanë afatin e vet të rregullt dhe do të mbahen në vitin 2021. Sipas tyre, është detyrë e opozitës ta kërkojë ardhjen në pushtet. Dukagjin Gorani, deputet i PSD-së, ka thënë se mungesa e vullnetit për zgjedhje të shpejta e të parakohshme u kuptua edhe në tryezat e fundit të partive politike. Kurse Lëvizja Vetëvendosje më 25 maj do ta organizojë tryezën e titulluar "Zgjidhja nëpërmjet zgjedhjeve", nëpërmjet së cilës synohet arritja e konsensusit për realizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare

## Kërkohet lobim në kryeqendrat e BE-së për liberalizim të vizave



Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe njohësit e integrimeve evropiane kanë bërë me dije se duhet të lobohet fuqishëm te vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) për liberalizimin e vizave. Meqenëse rol kyç në këtë proces do të kenë shtetet kryesore anëtare të BE-së, ata kanë deklaruar se Kosova duhet t'i informojë kryeqendrat e BE-së për gjithë progresin që është arritur në këtë drejtim FAQE 3



## Drita, kampione e Kosovës

Drita e Gjilanit e ka fituar edhe titullin e dytë në historinë e saj. Këtë sukses skuadra e Bekim Isufit e ka arritur pas barazimit ndaj Prishtinës (0:0) në ndeshjen e zhvilluar të dielën në Pejë, në praninë e mbi 4 000 shikuesve. Tashti Kosovën në gara ndërkombëtare do ta përfaqësojnë Drita në Ligën e Kampionëve dhe Prishtina në Ligën e Evropës FAQE 18

### AKTUALE



DUBRAVA, KY ANKTH I PAHARRUESHËM F. 11
SADIK ZEQIRI

VESELI FTON BASHKATDHETARËT TA INVESTOJNË KAPITALIN DHE DIJEN NË KOSOVË F. 5

PDK-JA KËRKON NGRITJEN E DISA SHTATOREVE NË PRIZREN F. 10

NË QKUK KRYHET NJË INTERVENIM I RRALLË F. 6

### EKONOMI

KEK-U: NUK E KEMI DHËNË PAGËN E 13 F. 8

BE-ja OFRON SHUMË MUNDËSI, POR KOSOVA S'KA KAPACITETE F. 8

### KULTURË

NATËN NË FSHAT F. 14-15
KAZUO ISHIGURO

JETA ME SHPIRT SHQIPONJE F. 13
Bardhyl MAHMUTI

### SPORT

SHKËMBI: ERDHA TRAJNER, PO LARGOHEM QYTETAR F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051 044/367-061 028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Drashkoviqi: Vuçiqi e di se e ka humbur Kosovën



BEOGRAD, 20 MAJ - Ish-ministri i Jashtëm i Serbisë, tani lider i Lëvizjes për Ripërtëritjen Serbe, Vuk Drashkoviq, është duke i përkrahur deklarimet e presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, se dëshiron ta zgjidhë problemin me Kosovën. Duke iu referuar deklarimeve të Vuçiqit në Samitin e Sofjes, Drashkoviqi ka thënë se presidenti serb është duke paraqitur qëndrimet reale për Kosovën pasi, sipas tij, e di se e ka humbur atë. "Vuçiqi na e kujton me kujdes, pasi e di edhe ai se Kosova është e humbur. Kjo është një luftë që ne e kemi nënshkruar, pra nuk ka shtet të Serbisë në Kosovë. Vendosi edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë se ky vendim nuk është në kundërshtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara", ka thënë Drashkoviqi. Ai ka theksuar se qëndrimi i tij kundër referendumit për Kosovën është pasi serbët nuk po i njohin faktet dhe po e cilësojnë Kosovën pjesë të Serbisë.

# Greqia refuzon emrin e ri për Maqedoninë

Pas konsultimeve me presidentin e vendit dhe aktorët politikë të shtetit grek, kryeministri Aleksis Tsipras është tërhequr nga propozimi "Republika Ilindenska Makedonija"



ATHINË, 20 MAJ - Edhe pse u mendua se zgjidhja përfundimtare e emrit të Maqedonisë ishte më pranë se kurrë, Qeveria greke e përmbysi situatën. Një ditë pas konsultimeve me presidentin e vendit dhe aktorët politikë të shtetit grek, kryeministri Aleksis Tsipras është tërhequr nga propozimi "Republika Ilindenska Makedonija".

Nga kabineti i shefit të ekzekutivit grek ka ardhur reagimi se është për t'u përshëndetur fakti që pala tjetër në Shkup ka pranuar se nuk mund të ketë zgjidhje për të gjitha përdorimet. "Ne i inkurajojmë për çdo rast fqinjët tanë, që të vazhdojmë të punojmë së bashku për të gjetur një zgjidhje të përbashkët me përcaktim gjeografik ose kohor, siç është propozuar nga ana e negociuesit, Mathew Nimic", thuhet në njoftimin e kabinetit të Tsiprasit.

Një ditë më parë gati të gjithë liderët e opozitës greke e refuzuan propozimin e ri me pretendimin se përmes tij "përforcohet irredentizmi" dhe se përmban elemente shoviniste. Emri "erga omnes", që përmend Qeveria greke, nënkupton një përcaktim me përdorim si brenda ashtu edhe jashtë vendit, nga të gjithë.

Në një bisedë telefonike, zëvendëspresidenti amerikan Mike Pence e kishte përgëzuar kryeministrin Tsipras për rolin e tij në negociatat për emrin e fqinjit verior të Greqisë, duke kujtuar se edhe koha e bisedimeve duhet marrë parasysh, ndërsa lideri grek ka vënë edhe një herë në dukje pozicionimin e Qeverisë së tij për çështjen në fjalë.

Pas refuzimit të propozimit nga ana e Athinës zyrtare për emrin e ri të Maqedonisë në "Republika Ilinditase e Maqedonisë", ka pasuar edhe reagimi i Qeverisë së Maqedonisë, ku shpjegon se emri i ri i propozuar është një emër me përcaktim kohor e cila thirret në data konkrete nga e kaluara dhe është mundësi reale për kompromis duke kënaqur të dyja palët. Nga Qeveria e Maqedonisë kanë thënë se shpresojnë se propozimi do të mirëkuptohet dhe do të pranohet edhe në Athinë.

## Mali i Zi, gardh me gjemba me Shqipërinë



PODGORICË, 20 MAJ - Mali i Zi po planifikon të ndërtojë një gardh me gjemba në kufi me Shqipërinë për shkak të numrit të lartë të refugjatëve të paligjshëm që tentojnë të kalojnë për në vendet e Bashkimit Evropian.

Vojislav Dragoviq, shef i Departamentit për Mbikëqyrje të Kufirit Shtetëror në Malin e Zi, tha se gardhi me tela është një mundësi reale, në rast se do të ketë fluks më të madh refugjatësh. Dragoviqi tha se autoritetet shqiptare shpesh kanë refuzuar t'i pranojnë klandestinët e kthyer nga Mali i Zi në bazë të marrëveshjes bilaterale për riatdhesim. Sipas agjencisë "Reuters", me mijëra refugjatë nga Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore po përpiqen të shkojnë në vendet më të pasura të Bashkimit Evropian dhe trafikantët kanë krijuar një shteg të ri ballkanik që nga Greqia kalon përmes Shqipërisë, Malit të Zi dhe Bosnjës për të mbërritur në Kroaci, anëtare e BE-së.

Bosnja tashmë po përballet me mijëra refugjatë që janë ngujuar në këtë vend, pasi rruga që kalonte përmes Turqisë, Greqisë, Maqedonisë dhe Serbisë u mbyll në vitin 2016, kur Turqia u pajtua ta frenojë rrjedhën e refugjatëve në këmbim të ndihmës së BE-së.

## Paloka: T'i japim fund Qeverisë që i shërben krimit




TIRANË, 20 MAJ - Nënkryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Edi Paloka, sërish ka akuzuar kryeministrin Edi Rama dhe ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj, se janë të implikuar në trafikun e drogës dhe se po shkatërrojnë provat. "Edi Rama gënjeu kur tha se ka bërë analizim të zërit në një agjenci të huaj, pasi ende nuk thotë emrin e këtij institucioni. Ai e di mirë se Agron Xhafaj kontrollon trafikun e drogës në qytetin e Vlorës, ndërsa i vëllai, Fatmiri, qëndron në ministri për t'i shkatërruar të gjitha provat me ndihmën e Prokurorisë së kapur", deklaroi Paloka.

Më tej, zyrtari i Partisë Demokratike përsëriti edhe një herë thirrjen për të marrë pjesë në protestën e organizuar opozita, të shtunën e ardhshme, më 26 maj. "Ju ftoj edhe një herë të gjithëve, të protestojmë së bashku ditën e shtunë, për ta larguar nga pushteti ministrin e drogës dhe trafikut dhe për t'i dhënë përgjigjen e merituar kësaj qeverie arrogante, që u shërben vetëm kriminelëve", tha Paloka.

## Gjukanoviqi betohet si president i Malit të Zi



PODGORICË, 20 MAJ - Milo Gjukanoviqi është inauguruar në postin e presidentit të Malit të Zi. Kjo është hera e dytë që ai shërben në postin e presidentit, pas mandatit të tij të parë prej vitit 1998 deri më 2002. "Mali i Zi është bërë shteti ekonomikisht më i zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe lider i reformave dhe negociatave me Bashkimin Evropian dhe sigurisht, anëtari i parë që i është bashkuar Aleancës", tha Gjukanoviqi pasi bëri betimin para Parlamentit.

Gjukanoviqi, 56 vjeç, fitoi 54 për qind të votave në zgjedhjet e mbajtura më 15 mars, duke shmangur kështu raundin e balotazhit dhe duke vazhduar dominimin në politikën e Malit të Zi për pothuajse tri dekada.

Gjukanoviqi ishte bërë kryeministri më i ri i Evropës më 1991. Ai atëbotë ishte 29-vjeçar. Jugosllavia në atë kohë kolapsoi, por Gjukanoviqi mbajti marrëdhënie të ngushta me presidentin e atëhershëm të Jugosllavisë, Slobodan Milosheviq, deri kur ndërpreu marrëdhëniet më 1998 dhe e udhëhoqi Malin e Zi drejt pavarësisë nga Serbia më 2006.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kosova nuk duhet të rrijë duarkryq për ta pritur vendimin për liberalizimin e vizave

# Kërkohet lobim në kryeqendrat e BE-së për liberalizimin e vizave

**Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe njohësit e integrimeve evropiane kanë bërë me dije se duhet të lobohet fuqishëm tek vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) për liberalizimin e vizave. Meqenëse rol kyç në këtë proces do të kenë shtetet kryesore anëtare të BE-së, ata kanë deklaruar se Kosova duhet t'i informojë kryeqendrat e BE-së për gjithë progresin që është arritur në këtë drejtim. Ndërsa përfaqësuesit e opozitës kanë përmendur hezitimin e disa shteteve anëtare në raport me liberalizimin e vizave**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

Prishtina, 20 maj - Institucionet e Kosovës duhet të ndërmarrin një fushatë lobuese nëpër kryeqendrat e Bashkimit Evropian (BE) për procesin e liberalizimit të vizave. Përfaqësuesit qeveritarë dhe njohësit integrimeve evropiane kanë bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se qendrave të BE-së në mënyrë të qartë dhe të matshme duhet t'u komunikohet progresi i arritur në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se në vend se të merremi me caktimin e datave se kur mund të lëvizet pa viza, duhet të ketë kontakte të vazhdueshme me vendet anëtare të BE-së për këtë proces. "Në të njëjtën kohë ne duhet të shohim se si duhet të bashkëpunojmë me disa shtete anëtare të BE-së, veçanërisht me Gjermaninë, ku kam qëndruar para dy jave, me Francën, me Austrinë, por edhe me Holandën, Belgjikën, si dhe disa shtete anëtare, meqë vendimmarrja e Komisionit Evropian është një vendimmarrje ku vendos komisionari për Migrim dhe Çështje të Brendshme, Dimitris Avramopoulos, të cilin e kam takuar gjatë kësaj vizite dhe komisionarin për Zgjerim dhe Fqinjësi të Mirë, Johannes Hahn", ka thënë ai, duke shtuar se në këtë drejtim duhet të bëhet punë lobuese. "Besoj se nuk ka arsye për pesimizëm por, përkundrazi, ka arsye për optimizëm. Ne duhet të shohim që ta mbajmë gjallë këtë agjendë dhe në vend se të japim data në Prishtinë, të bëjmë punë konkret lobuese në Bruksel dhe në qendrat e tjera evropiane", ka deklaruar Hoxhaj.

Edhe njohësi i integrimeve evropiane, Taulant Kryeziu, ka bërë me dije për "Epokën e re" se një fushatë e tillë është shumë e nevojshme ngaqë, sipas tij, duhet pasur parasysh se ka mungesë të entuziazmit brenda shteteve anëtare për liberalizimin e vizave me vendet e treta. Ai ka vlerësuar se ky është një proces teknik me vendimmarrje politike që rol kyç do të kenë shtetet kryesore anëtare të BE-së. "Mjedisi politik në kuadër të vendeve anëtare në vitin 2018 nuk është mjedis politik i vitit 2012 kur është lansuar procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën. Vitet e fundit vendet anëtare janë ballafaquar me presion të fuqishëm publik për heshtjet siç janë migrimi, azilkërkuesit, terrorizmi etj. Po ashtu, ka pasur ide për suspendim të regjimit të vizave me vendet e Ballkanit Perëndimor që tashmë kanë fituar liberalizimin e vizave. Prandaj, duhet nënvizuar se Kosova ballafaqohet me një mjedis negativ publik dhe politik për liberalizimin e vizave. Vendet anëtare të rëndësishme, siç janë Franca, Suedia, Holanda, kanë shfaqur rezerva të mëdha për heqjen e regjimit të vizave për Kosovën", ka thënë Kryeziu.

Për këto arsye, sipas Kryeziut, institucionet e Kosovës duhet të komunikojnë me vendet anëtare të BE-së dhe t'ua tregojnë progresin që është arritur. "Konsideroj se duhet të lobohet në kryeqytetet e vendeve anëtare të BE-së dhe t'u komunikohet në mënyrë të qartë dhe të matshme progresi i arritur në Kosovë në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave. Në veçanti, vendeve anëtare duhet t'u komunikohen masat që Kosova ka marrë në fushën e azilkërkuesve, migrimit dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Këto janë temat e interesit vital për vendet anëtare", është shprehur Kryeziu.

Më tej, ai ka treguar procedurën se si do të shkojë deri te vendimmarrja e BE-së për liberalizim të vizave. "Në skenarin pozitiv ku konfirmohet përmbushja e të gjitha kritereve, BE-ja fillon procesin vendimmarrës ku duhet një votim në Parlamentin Evropian me shumicë të thjeshtë në lexim të parë dhe shumicë absolute në lexim të dytë, kurse edhe votim në Këshill të BE-së, në përbërje të ministrave të brendshëm dhe të drejtësisë, me shumicë të dyfishtë, pra 55 % të vendeve anëtare (16) që përfaqësojnë së paku 65 % të popullsisë së BE-së", ka treguar Kryeziu, duke përmendur rastin e Gjeorgjisë dhe të Ukrainës se sa kohë u është dashur qytetarëve të këtyre shteteve të lëvizin në Zonën Shengen. "Nëse marrim si shembuj referues rastin e Gjeorgjisë dhe të Ukrainës, nga momenti që këto dy vende kanë marrë mandatin nga komisioni LIBE (të drejta civile, drejtësi, punë të brendshme), aty ku gjendemi ne e deri tek lëvizja e lirë ka zgjatur gjashtë muaj për Gjeorgjinë dhe nëntë muaj për Ukrainën, por po flasim gjithmonë nën presupozimin se kemi përmbushur edhe kriterin e fundit, për të cilin duhet pritur raportin final nga misioni faktmbledhës i Komisionit Evropian që ishte në Kosovë në fillim të muajit majit", ka thënë Kryeziu.

Hezitimi i disa shteteve anëtare të BE-së në raport për liberalizimin e vizave është përmendur edhe nga opozita. Nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka ftuar institucionet e Kosovës të punojnë me këto vende. "Rekomandimi do të qartësohet, por data do të vijë nga Këshilli i Ministrave dhe në këtë rrafsh duhet të punojmë shumë me presidentin Donald Tusk dhe me shtetet që nuk e pranojnë pavarësinë e Kosovës. Po ashtu, kemi edhe numër të shteteve që kanë hezitime serioze në këtë çështje", ka deklaruar Haziri.



Cineberg (Shutterstock)

Deputetët e partive në pushtet e komentojnë kërkesën e opozitës për zgjedhje të reja

# Kërkesa e opozitës për zgjedhje



**Kërkesa e opozitës për zgjedhje të reja nuk po shihet si përpjekje serioze nga deputetët e partive në pushtet. Zenun Pajaziti dhe Blerim Kuçi kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se zgjedhjet parlamentare e kanë afatin e vet të rregullt, të cilat do të mbahen në vitin 2021. Sipas tyre, është në rolin e opozitës ta kërkojë ardhjen në pushtet. Dukagjin Gorani, deputet i PSD-së, ka thënë se mungesa e vullnetit për zgjedhje të shpejta e të parakohshme u kuptua edhe në tryezat e fundit të partive politike. Kurse Lëvizja Vetëvendosje më 25 maj do ta organizojë tryezën e titulluar "Zgjidhja nëpërmjet zgjedhjeve", ku përmes kësaj tryeze synohet arritja e konsensusit për realizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 20 MAJ - Deputetët e partive në pushtet, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismës Socialdemokrate, kanë thënë se opozita nuk e ka përnjëmend kërkesën e saj për zgjedhje të parakohshme. Deputeti i PDK-së, Zenun Pajaziti, ka thënë për "Epokën e re" se askush në Kosovë nuk e ndien veten komod të hyjë tani në proces zgjedhor, aq më tepër qytetarët e Kosovës që vitin e kaluar kanë dalë në dy palë zgjedhje. "Ne nuk mund t'u ikim procedurave demokratike që janë të parapara me ligj dhe Kushtetutë. Kushdo qofshin ata, nëse i përmbushin procedurat ligjore, ne nuk mund t'u ikim atyre. Në këtë rast edhe zgjedhjet nuk janë tabu. Të gjithë duhet të jemi të gatshëm të përballemi me diçka që është ligjore dhe kushtetuese. Mendoj se tani duhet t'i shikojmë interesat e vendit dhe të qytetarëve, të cilat na thonë se ne nuk duhet t'u ikim përgjegjësive tona. Në këtë rast, do të duhej të kemi pjesëmarrje më aktive edhe të opozitës në proceset e rëndësishme për vendin, siç është dialogu me Serbinë dhe proceset e tjera që na presin. Tani për tani as partnerët tanë nuk i mirëpresin zgjedhjet e reja dhe nuk mendoj se ato mund të ofrojnë zgjidhje, apo një spektër tjetër politik i cili do t'u jepte një përgjigje tjetër këtyre sfidave që i kemi përpara", ka thënë Pajaziti.

Ai beson se tani i gjithë spektri politik në Kosovë është i vetëdijshëm se çfarëdo lloj qeverie të ishte do të duhej të përballej me sfidat që janë para nesh. "Askush në Kosovë nuk e ndien veten komod të hyjë tani në proces zgjedhor, aq më tepër qytetarët e Kosovës që vitin e kaluar kanë dalë në dy palë zgjedhje. Pra, askush nuk e pret një gjë të tillë", është shprehur deputeti i PDK-së, Zenun Pajziti.

Deputeti i AAK-së, Blerim Kuçi, ka thënë se zgjedhjet parlamentare e kanë afatin e vet të rregull. "Zgjedhjet parlamentare e kanë afatin e vet të rregullt. Data e zgjedhjeve është e caktuar. Zgjedhjet mbahen në vitin 2021. Është në rolin e opozitës ta kërkojë ardhjen në pushtet kurdo që i krijohen mundësitë. LDK-ja, duke qenë parti opozitare, në momentin që i ka votat, mund të kërkojë mocion për rrëzimin e Qeverisë", ka thënë Kuçi. Ai ka theksuar se krejt kjo çfarë po bën LDK-ja është çështje elektorale. "LDK-ja është e pafuqishme për ta kërkuar mocionin për rrëzimin e Qeverisë. Po ashtu, është e pavullnetshme për të qenë në pushtet sepse e di se epilogu i proceseve të mëdha nuk do të jetë i lehtë. Vendimet janë të mëdha dhe nuk besoj se ata kanë dëshirë që në këtë kohë dhe në harmoni me rrethanat që i kanë brenda në parti, t'i udhëheqin proceset e mëdha për vendin. LDK-ja nuk i ka as votat, as vullnetin dhe as guximin për të qenë në pushtet në këtë kohë kur pritet epilogu i dialogut me Serbinë", është shprehur Kuçi.

Ai ka shtuar se kryeministri Haradinaj është duke kryer punë të mira. "Pavarësisht prej kritikave të shumta, qeverisja në aspektin strategjik po shkon konform zgjidhjes së sfidave që janë shumë të rëndësishme për Kosovën. Nuk po kemi problem sepse ligjet dhe çështjet e rëndësishme po aprovohen. Por, si parti dhe Qeveri jemi të interesuar të kemi stabilitet edhe në votë, dhe këtë do ta zgjidhim shpejt", është shprehur Kuçi.

Ndërkaq deputeti i Nismës Socialdemokrate, Milaim Zeka, ka thënë se deklarimet për shkuarje në zgjedhje të reja janë sa për të

# të reja, përpjekje joserioze



bërë fushatë. "Boll e shkokërdhavtë është kjo Qeveri, veçse opozita është edhe më e shkokërdhavtë. Krejt këto deklarime partitë opozitare i bëjnë vetëm sa për fushatë, sepse nuk e kanë seriozisht. Për mendimin tim, askush këtu nuk po bën opozitë. Shiko se çfarë interpelancash thërrasin. Qeveria rrëzohet veç kur të duan amerikanët, Brukseli dhe kur duam ne që jemi pozitë. Sa për këtë opozitë, kjo Qeveri edhe 1 000 vjet nuk rrëzohet", ka thënë Zeka.

Edhe deputeti i Partisë Socialdemokrate, Dukagjin Gorani, ka thënë se asnjë subjekt politik nuk është i interesuar që zgjedhjet e reja të mbahen tani. "Pavarësisht prej tensioneve që u ngrehën gjatë ditëve të kaluara, mungesa e vullnetit për zgjedhje të shpejta e të parakohshme u kuptua në tryezën e fundit të partive politike, të organizuar nga LDK-ja. Grupi i Deputetëve të Pavarur nuk e përkrah idenë e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme gjatë këtij viti. Arsyeja për këtë është se ato nuk do të sjellin ndryshim përmbajtjesor të qeverisjes, por vetëm ndërrim të Qeverisë me aktorë të ngjashëm në pushtet, mbase të njëjtë", ka thënë Gorani.

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se në asnjë mënyrë nuk e kanë menduar periudhën kohore apo datën për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme, mirëpo kanë menduar vetëm formën e arritjes së marrëveshjes. "Data, muaji dhe viti i mbajtjes së zgjedhjeve është çështje e përbashkët që partitë politike duhet ta harmonizojnë me njëra-tjetrën. Kjo varet shumë nga detyrat dhe prioritetet që vendosen", ka thënë Haziri.

Kurse Lëvizja Vetëvendosje ka njoftuar se më 25 maj do ta organizojë tryezën e titulluar "Zgjidhja nëpërmjet zgjedhjeve", ku do t'i ftojë subjektet politike në Kosovë. Sipas Vetëvendosjes, përmes kësaj tryeze do të synohet arritja e konsensusit "për realizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare". "Kjo tryezë mbahet me synim të arritjes së konsensusit për realizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Republikën e Kosovës, si zgjidhja demokratike që do të mundësonte krijimin e një qeverisjeje legjitime të shumicës për t'i çuar përpara proceset e domosdoshme politike dhe ekonomike për shtetndërtimin e Republikës së Kosovës, zhvillimin e vendit dhe integrimet euroatlantike, duke përfshirë këtu edhe pakicat në shtetin tonë e raportin me fqinjët tanë", është thënë në njoftimin e Vetëvendosjes.

Njohësi i proceseve politike në vend, Behxhet Shala, ka thënë për gazetën se kërkesa për zgjedhje të reja më tepër është një kërcënim sesa përpjekje serioze e subjekteve politike. "Nuk ka gatishmëri dhe as kushte për mbajtje të zgjedhjeve të parakohshme. Madje mbajtja e zgjedhjeve nuk do të kishte kuptim pa u kryer një reformë e thellë zgjedhore", ka thënë Shala.

# Veseli fton bashkatdhetarët ta investojnë kapitalin dhe dijen në Kosovë

**Rahovec, 20 maj (ER)** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka marrë pjesë në vendosjen e gurthemelit të një projekti të ri prej shtatë milionë eurosh që ka filluar kompania "Stone Castle Resort" në Komunën e Rahovecit, e që ka për qëllim turizmin dhe sjelljen e vizitorëve nga mbarë bota për t'i vizituar vreshtat e Rahovecit dhe Kosovën.

Në ceremoninë e gurthemelit, kryeparlamentari Veseli ka thënë se investitori Rrustem Gecaj po e transformon industrinë e bujqësisë edhe në industri të turizmit. "Sot po i jepni një dimension të ri të zhvillimit Komunës së Rahovecit dhe krejt Republikës së Kosovës, duke e transformuar industrinë e përpunimit të verës, përkatësisht bujqësinë në tërësinë e vet, edhe në industri të turizmit. Ne ju jemi falënderues për këtë sukses. Kjo është ajo çfarë i duhet Kosovës. Në të njëjtën kohë i falënderojmë qytetarët e Komunës së Rahovecit, të cilët janë njerëzit më punëtorë në Republikën e Kosovës, janë dora e artë e punës", ka thënë Veseli.

Duke folur për shembullin e suksesit të investitorit Gecaj nga diaspora në Kosovë, kryeparlamentari Veseli ka ftuar edhe bashkatdhetarët e tjerë të suksesshëm ta sjellin jo vetëm kapitalin e tyre në Kosovë, por ta sjellin edhe dijen e përvojën e fituar. "Në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës ju falënderoj për këtë investim të jashtëzakonshëm. Para disa ditësh në Kuvendin e Kosovës kishim disa dhjetëra, qindra intelektualë, biznese nga diaspora. Një nga momentet më të suksesshme në Kosovë do të jetë kur diaspora jonë do të transformohet për pjesën e investimeve në atdheun e vet. Që ta sjellin jo vetëm kapitalin, por edhe dijen. Ne institucionet e Republikës së Kosovës qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe qytetarët e Republikës së Kosovës janë shumë falënderues për këto investime që jeni duke i vazhduar në Komunën e Rahovecit", ka thënë Veseli.

Ndërsa pronari i kompanisë investuese, Rrustem Gecaj, e ka falënderuar kryeparlamentarin Veseli për përkrahjen e vazhdueshme që ua ka dhënë investitorëve. Ai ka thënë se projekti i ri që ka filluar në Rahovec do të punësojë mbi 50 qytetarë, ndërsa do ta shndërrojë këtë pjesë të Kosovës si destinacion mjaft interesant për turistët të cilët do të kenë mundësi të pushojnë në këtë zonë dhe t'i vizitojnë vreshtat e mrekullueshme të Kosovës.



# Rreth 350 persona të deportuar dhe ekstraduar nga Kosova



Visar Kryeziu (AP)

**Prishtinë, 20 maj** - Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës kanë bërë me dije se rreth 350 persona janë deportuar dhe ekstraduar nga territori i Kosovës për në shtetet e ndryshme botërore që nga viti 2017 e deri më tash. Autoritetet kompetente në Kosovë vitin e kaluar kanë ekstraduar 44 persona nga Republika e Kosovës për në shtetet e tjera apo anasjelltas. Sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë, nga 44 personat, 25 ishin ekstradime nga shtetet e tjera për në Kosovë, kurse 15 persona janë ekstraduar nga territori i Kosovës për në vendet e tjera. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se aktualisht janë edhe dy raste të ekstradimit nga Kosova në shtete tjera.

Ndërkaq katër ekstradime kanë qenë transit, ku Ministria e Drejtësisë ka dhënë leje për shfrytëzimin e territorit të Republikës së Kosovës. "Ka pasur raste të ndryshme të ekstradimit, duke filluar nga vrasjet, vjedhje të rëndë, trafikim të qenieve njerëzore, trafikim të narkotikëve. Tashmë unë kam nënshkruar edhe dy ekstradime të shtetasve të huaj që kanë qenë në Kosovë dhe janë kërkuar nga vendet e tyre", ka thënë ministri Tahiri për "REL".

Në një përgjigje nga kjo ministri thuhet se numri më i madh i ekstradimeve është realizuar me shtetet si Gjermania, Zvicra, Belgjika, Austria, Italia, Hungaria, Mal i Zi, Shqipëria, Maqedonia dhe kështu me radhë.

## Ekstradimi

Ekstradimi realizohet kur një person kryen një vepër penale në një shtet të caktuar dhe gjatë procedurës penale, apo pas caktimit të dënimit, largohet në një shtet tjetër me qëllim të shmangies së dënimit. Në këtë rast shteti ku gjendet i kërkuari ia dorëzon personin shtetit kërkues ku ai ka kryer veprën penale. Kjo çështje në Kosovë rregullohet në bazë të Ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2011. Sipas këtij ligji, "personi mund të ekstradohet me qëllim të ndjekjes penale apo ekzekutimit të dënimit. Procedura për ekstradimin e personit iniciohet vetëm mbi bazën e lutjes me shkrim të shtetit kërkues drejtuar Ministrisë".

Ndërsa organizatat që merren me të drejtat e njeriut në Kosovë theksojnë se autoritetet kompetente në Kosovë në të gjitha rastet kanë përfillur procedurat ligjore për zbatimin e ekstradimit dhe largimit të personave që bien ndesh më ligjin.

Behxhet Shala, drejtor ekzekutiv në Këshillin për Mbrojtjen Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Kosovë (KMLDNJ), ka thënë për "REL" se deri tek depërtimi i gjashtë shtetasve turq autoritetet e Kosovës kanë respektuar bazën ligjore për ekstradim dhe deportim. "Ata të cilët e kanë marrë vendimin për ekstradim i kanë shfrytëzuar të gjitha mundësitë e kundërshtimit dhe kur kanë shterur mundësitë ligjore janë ekstraduar. Ekstradimi është një dukuri që në Kosovë ndodh shpesh, mirëpo kalon në heshtje sepse nuk prodhon ndonjë efekt. Ata ekstradohen pasi dikush ka bërë krime, dikush ndonjë vepër tjetër penale. Kjo është krejt normale", ka thënë Shala.

## Deportimi

Një formë tjetër e dëbimit të shtetasve të huaj është deportimi. Rreth 320 është numri i shtetasve të huaj që janë deportuar prej vitit 2017 e deri më tash nga Kosova në vende të ndryshme të Evropës dhe më gjerë.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, ka thënë se deportimet realizohen në dy forma, në bazë të vendimit të gjykatës dhe urdhërlargimet me forcë që nxirren dhe ekzekutohen nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj, që funksionin në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. "Sa iu përket urdhërlargimeve me vendim gjykate, kjo nënkupton që këta shtetas të huaj u janë nënshtruar një procedure gjyqësore, domethënë kanë qenë të akuzuar/dënuar për vepra të ndryshme penale dhe deportimi si masë është ekzekutuar nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj me kërkesë të gjykatës. Urdhërlargimet me forcë nxirren dhe ekzekutohen nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj. Këto vendime lëshohen kundër shtetasve të huaj në përputhje me Ligjin për të huaj", ka theksuar Zeka.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, ka pohuar se më së shumti deportime nga Kosova për në vende të tjera janë realizuar për në Shqipëri, Turqi dhe Serbi. Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në vitin 2017, me vendim të gjykatës, janë ekzekutuar 15 deportime, kurse 246 janë realizuar me forcë. Nga Kosova për në Shqipëri, prej vitit të kaluar e deri në këtë muaj, janë larguar 264 persona, në Turqi 15, në Maqedoni 6 persona, 5 në Serbi, kurse më pak se 5 persona janë deportuar për në Bullgari, Kolumbi, Filipine, Bosnje Hercegovine, Tunizi dhe Pakistan. "Janë vepra të ndryshme penale që kanë bërë në Kosovë. Do të thotë, ata që janë dëbuar me vendim të gjykatës është numër më i vogël. Arsyeja kryesore e shumicës së këtyre urdhërlargimeve me forcë, si për vitin 2017 ashtu edhe për vitin 2018, është se këta persona kanë hasur duke qëndruar ilegalisht në territorin e Kosovës, që do të thotë janë në kundërshtim me Ligjin për të huaj", ka thënë Zeka.

## Deportimi i shtetasve turq

Në muajin mars autoritetet e sigurisë së Kosovës, në bashkëpunim me Inteligjencën turke, kanë arrestuar, më pas kanë deportuar nga Kosova për në Turqi, gjashtë persona, pesë prej të cilëve punonin në institucionet arsimore në Kosovë dhe njëri në ato shëndetësore.

Arsyetimi i autoriteteve të sigurisë në Kosovë për largimin e gjashtë shtetasve turq ka qenë se këta persona paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare.

Ky veprim kishte nxitur reagimet e krerëve më të lartë të shtetit, por edhe faktorit ndërkombëtar në Kosovë. Behxhet Shala nga KMLDNj-ja ka theksuar se autoritetet kompetente në këtë rast kanë shkelur të gjitha normat ligjore duke bërë shkelje të të drejtave të njeriut. "Në rastin e 'gylenistëve' nuk ka qenë as ekstradim as deportim, por ka qenë kidnapim i njerëzve, abuzim i skajshëm edhe me ligjin dhe me të drejtat e njeriut dhe të gjitha normat ligjore, morale, njerëzore etj. Atyre nuk u është dhënë mundësia të shfrytëzojnë asnjë të drejtë ligjore për ta kundërshtuar deportimin eventual dhe për këtë arsye ne kemi reaguar dhe do të reagojmë", ka thënë Shala.

## Riatdhesimi

Edhe riatdhesimi paraqet një formë të pranimit të shtetasve nga vendet e tjera, duke i akomoduar ata sërish me vendin amë. Nga viti i kaluar e deri më tani, nga shtete të tjera në Kosovë janë riatdhesuar rreth 5 000 persona në mënyrë vullnetare apo të detyruar. Vetëm gjatë këtij viti janë riatdhesuar 450 persona.

# Deri më 10 qershor AAK-ja do t'i përmbyllë zgjedhjet nëpër degë

"Jam i kënaqur me procesin e deritashëm të brendshëm zgjedhor në Aleancë. Ky proces duhet të vazhdojë të jetë sa më gjithëpërfshirës. Ftoj të gjithë kryetarët e degëve dhe të gjithë aktivistët tanë të punojnë sa më afër dhe të ofrojnë profesionistë, njerëz të profileve të ndryshme", ka thënë lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj

Qendresa RAMA

**Prishtinë, 20 maj** - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, në mbledhjen e rregullt të Kryesisë së AAK-së ka folur për procesin zgjedhor në parti dhe për zhvillimet në vend. Haradinaj procesin zgjedhor në parti e ka cilësuar të mirë dhe gjithëpërfshirës. "Jam i kënaqur me procesin e deritashëm të brendshëm zgjedhor në Aleancë. Ky proces duhet të vazhdojë të jetë sa më gjithëpërfshirës. Ftoj të gjithë



kryetarët e degëve dhe të gjithë aktivistët tanë të punojnë sa më afër dhe të ofrojnë profesionistë, njerëz të profileve të ndryshme. Të punojmë bashkërisht me të gjithë anëtarët, simpatizantët dhe qytetarët e Kosovës", ka thënë Haradinaj.

Në këtë takim nga Kryesia u votua unanimisht edhe zgjedhja e Lulzim Lecit në pozitën e sekretarit ekzekutiv të partisë. Duke folur për proceset politike në vend, Haradinaj ka thënë se Kosova është duke punuar bashkë me partnerët ndërkombëtarë për integrimin dhe zhvillimin e mëtejmë.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës po vazhdon mbajtjen e zgjedhjeve të brendshme dhe deri më tani ka përfunduar procesi në degën e Ferizajt, të Gjakovës, të Hanit të Elezit, të Junikut, të Kaçanikut dhe të Vitisë, kurse deri më 10 qershor Aleanca do t'i përmbyllë zgjedhjet në të gjitha degët.

# Intervenim i rrallë në QKUK, zgjidhet problemi i pacientes që kishte nga lindja

Arbisa SHEFKIU

**Prishtinë, 20 maj** - Në Klinikën e Ortopedisë me Traumatologji të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) është kryer një operacion i rrallë i implantimit të endoprotezës totale të kërdhokullës (vendosje e protezës totale në kërdhokull), tek pacientja 49-vjeçare me luksacion kongjenital të kërdhokullës (çrregullim zhvillimor i kërdhokullës që nga lindja). "Pacientja Q. B., 49-vjeçare, me luksacion kongjenital të kërdhokullës së djathtë (çrregullim zhvillimor i kërdhokullës së djathtë që nga lindja), e patrajtuar që nga lindja. Ajo në Klinikën e Ortopedisë është lajmëruar për shkak të problemeve në ecje dhe dhimbje në kërdhokullën e djathtë, pasi kishte lindur me këtë problem dhe nuk është trajtuar asnjëherë për këtë problematikë. Fillimisht bëhet vizita ambulatore ku, pas ekzaminimeve klinike dhe radiologjike, vendoset diagnoza dhe indikacioni për trajtim kirurgjik. Vërtetohet se te pacientja ekstremiteti i poshtëm i djathtë në matje ka shkurtesë 6 cm", është bërë me dije në njoftimin e QKUK-së.

Më tej në këtë njoftim thuhet se menjëherë ka filluar planifikimi i intervenimit me kompletim të analizave laboratorike dhe konsultimeve të nevojshme. "Rasti cilësohet i ndërlikuari i



këtij lloji në QKUK dhe mjaft sfidues, që zakonisht kryhet në klinika të specializuara për këtë problematikë", është thënë në këtë njoftim. Sipas njoftimit të QKUK-së, pas përgatitjeve preoperatore dhe konsultimit me anesteziolog më 16. 5. 2018, me anestezion spinal (dr. Agron Balaj dhe dr. Islam Krasniqi) dhe ekipi nnga ana e ortopedëve në krye me dr. Arber Tolaj, dr. Cen Bytyqi, dr. Rinor Velekinca dhe dr. Artan Bejta si dhe në instrumentale Fatmire G., është kryer intervenimi kirurgjik. "Fillimisht është bërë osteotomia (prerja e kockës) e pjesës së sipërme të femurit, në nivel të trohanterit të vogël, është bërë lirimi i strukturave të buta përreth femurit proksimal, krijimi i acetabulumit primar dhe është bërë implantimi i endoprotezës (vendosja e protezës) totale në kërdhokullën e djathtë me cement. Njëherësh është arritur edhe gjatësia e nevojshme e ekstremitetit. Gjendja e pacientit gjatë operacionit ishte stabile dhe pa probleme. Në rëntgen kontrollues vërehet pozitë korrekte e vendosjes së komponentit acetabulare dhe femorale. Pas operacionit janë kryer ekzaminimet kontrolluese, është konstatuar se intervenimi kirurgjik ishte kryer me sukses të plotë. Pacientja është ende e hospitalizuar, në pritje për ta filluar terapinë fizikale sipas protokollit", është theksuar në njoftimin e QKUK-së.



# Delawie, i zhgënjyer me Kuvendin e Kosovës

**Prishtinë, 20 maj** - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Greg Delawie, ka mirëpritur zgjedhjen e dy gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nga komunitetet joshumicë, Radomir Laban dhe Bajram Ljatifi, të cilët u votuan nga Kuvendi i Kosovës më 18 maj. Ndërkaq për kandidatët nga komuniteti shumicë shqiptare votimi u përsërit dy herë, por asnjëri nga lista e kandidatëve nuk arriti votat e mjaftueshme për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter", Delawie ka shprehur zhgënjimin e tij, që Kuvendi i Kosovës nuk arriti t'i përfundojë punimet në seancën e 18 prillit. "Mirëseardhje për dy gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. I zhgënjyer që Kuvendi nuk arriti t'i përfundojë punimet e veta. Ruani sistemin e drejtësisë së Kosovës dhe sa më shpejt riniseni procesin", ka shkruar Delawie.



# Limaj e gjenerali Ante Gotovina kujtojnë kohët e vështira

**Prishtinë, 20 maj** - Zëvendëskryeministri i Kosovës dhe kryetari i Nismës, Fatmir Limaj, ka takuar në Zagreb gjeneralin Ante Gotovina. Limaj, i cili në luftën e UÇK-së mbante nofkën "Çeliku", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" se me Gotovinën kanë rikujtuar kohët e vështira që kanë kaluar Kosova dhe Kroacia, por edhe ata si individë. "Ishte kënaqësi e veçantë që në rrethana krejtësisht të tjera ta takoja në Zagreb gjeneralin Ante Gotovina. Bashkërisht rikujtuam kohët e vështira në të cilat kanë kaluar vendet tona, por edhe ne si individë. Iu gëzuam suksesevee e të arriturave të vendeve tona. Përkushtimi i shteteve mike Kosovë - Kroaci është thellimi i bashkëpunimit ekonomik dhe integrimet evropiane si mision e interes strategjik i vendeve tona dhe rajonit në tërësi", ka thënë Limaj.

# BE-ja ofron shumë mundësi, por Kosova s'ka kapacitete



Bujar Tërstena (RFE/RL)

Prishtinë, 20 maj - Bashkimi Evropian po ofron mundësi të mëdha për zhvillimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, në këtë mes edhe për Kosovën, por këto mundësi, sidomos në aspektin ekonomik, duhet ditur të shfrytëzohen, thonë analistë nga fusha ekonomike.

Gjatë kësaj jave në Sofje të Bullgarisë është mbajtur Samiti i Bashkimit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor, ku përmes një deklarate të përbashkët është konfirmuar përkushtimi dhe vendosmëria për të ardhmen evropiane të rajonit. Ky samit ka nxjerrë si përfundim edhe përkushtimin për thellimin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme, siç është edhe aspekti ekonomik.

Profesor Gazmend Qorraj, ligjërues i lëndës Ekonomia e Kosovës dhe Bashkimi Evropian në Fakultetin Ekonomik, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" që Kosova të përfitojë nga mjetet dhe mundësitë që ofron Bashkimi Evropian duhet t'i ngrehë kapacitet. "Konsideroj se çdo samit i Bashkimit Evropian që mbahet për Ballkanin Perëndimor është i mirëseardhur sepse dërgon mesazhe që Bashkimi Evropian ka plane për Ballkanin Perëndimor. Aty ka premtime edhe për zhvillim, për investime në infrastrukturë dhe projekte të ndryshme, por një problem është sesa ne do të dimë t'i shfrytëzojmë ato mjete dhe ato mundësi që ofron Bashkimi Evropian", ka deklaruar Qorraj. Ai ka thënë se BE-ja përmes Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) ka afruar mundësi për tregti të lirë por Kosova, sipas tij, duhet të analizojë se çfarë përfitime ka pasur nga ato që deri më tani i ka ofruar BE-ja.

Qorraj ka pohuar se Kosova nuk ka përfituar shumë nga MSA-ja dhe ky është një mesazh që duhet të punohet më shumë. "Kosova duhet t'i ngrehë kapacitetet. Nëse nuk kemi bërë sa duhet deri më tani, t'i ngrehim kapacitet dhe të përftojmë nga Samiti i Bashkimit Evropian që u mbajt gjatë kësaj jave në Sofje. Është një mesazh i rëndësishëm për të ardhmen për ato që ofrohen tash e tutje nga BE-ja", është shprehur Qorraj.

Në kuadër të Samitit të Bashkimin Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Sofje ishin organizuar forume të ndryshme ekonomike. Në forumin "Perspektiva e investimeve - Ballkani Perëndimor", ishte pjesëmarrës edhe ministri i Zhvillimit Ekonomik në Qeverinë e Kosovës, Valdrin Lluka. Sipas një njoftimi të kësaj ministrie, Lluka ka prezantuar mundësitë që Kosova ofron në sektorë të ndryshëm, me fokus në energji, miniera dhe teknologji informative.

Lluka ka vlerësuar se integrimi i një tregu të përbashkët energjetik mbetet sfida kryesore në vend.

Ndërsa profesor Gazmend Qorraj ka thënë se është një lajm i mirë kur premtohet për Ballkanin por, sipas tij, duhet ndarë në mënyrë individuale procesin. "Mesazhi im është qe t'i shikojmë gjërat individualisht, jo të themi është një lajm i mirë për Ballkanin dhe ai vlen edhe për neve. Problemi është se aty përftojnë edhe në mënyrë individuale, pra nuk do të thotë se të gjithë përftojnë njëjtë. Përfitojnë ata të cilat kanë institucione më efikase dhe i qasen në mënyrë më serioze procesit", ka thënë Qorraj.

Në Samitin në Sofje është mbajtur edhe Forumi Ekonomik Botëror në të cilin takim Kosova është përfaqësuar nga zëvendëskryeministri, njëherësh ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli. Ai kishte theksuar se bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor është çelës për shfrytëzimin e potencialit ekonomik të rajonit. Megjithatë, sipas tij, mosmarrëveshjet bilaterale në nivel politik mbesin ende pengesë.

Vazhdimisht Bashkimi Evropian u ka kërkuar vendeve të Ballkanit Perëndimor të zhvillojnë projekte të përbashkëta, me standarde evropiane, në fushën e infrastrukturës rrugore, hekurudhore dhe doganore, me qëllim të lehtësimit të qarkullimit të njerëzve dhe mallrave.



# KEK-u: Nuk e kemi dhënë pagën e 13-të

Prishtinë, 20 maj (ER) - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka reaguar ndaj shkrimeve në medie me titull "KEK-u ua jep punëtorëve rrogën e 13". Sipas KEK-ut, ky lajm është i pavërtetë. "Nuk është e vërtetë që punëtorët e KEK-ut, menaxhmenti ose Bordi, kanë marrë rrogën e 13. Ky lajm është krejtësisht spekulim", është thënë në reagimin e KEK-ut.

Në reagim thuhet se KEK-u në emër të Bordit dhe Menaxhmentit i siguron të gjithë qytetarët se nuk ka ndërmarrë asnjë veprim të tillë siç spekulohet kundërligjshëm dhe në favor të dikujt duke e dëmtuar buxhetin e Korporatës. "KEK-u ka arritur të jetë kompania publike me performancën më të mirë në Kosovë. Ndërmarrja më stabile financiare dhe që ka arritur t'i tejkalojë krizat më të mëdha të njohura tashme për publikun, siç ishte rasti me shpronësimet në Hade dhe Shipitullë", është thënë në reagimin e KEK-ut, duke shtuar se sa i përket rritjes së pagave, kjo është publike. "Kjo është e njohur për të gjithë se ka qenë kërkesë e aksionarit, vendim i kërkuar nga Qeveria e Kosovës për t'i rritur pagat për 100 euro, duke u bazuar në kërkesat e Sindikatave të Punëtorëve", është theksuar në reagimin e KEK-ut.

# A do të ulen pagat në Telekomin e Kosovës?



**Brenda kësaj jave Bordi i Telekomit të Kosovës pritet të dalë me një plan të ristrukturimit të kësaj ndërmarrje, ku parashihen edhe masat emergjente që duhen të ndërmerren për shpëtimin nga falimentimi. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se Telekomi ka një humbje prej 15 milionë eurosh në vit dhe duhen të gjenden forma se si të mbulohen këto humbje. Për shpëtimin e Telekomit të Kosovës po kërkohet ulja e shpenzimeve operative siç janë qiratë, kostot e mirëmbajtjes dhe marketingut, si dhe ulja e pagave për punëtorët në këtë ndërmarrje**

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 MAJ - Telekomi i Kosovës gjendet në krizë të thellë financiare dhe rrezikon të falimentojë, pasi borxhi i akumuluar ka arritur shifrën e 60 milionë eurove. Për krizën financiare të kësaj kompanie kryesuesja e Bordit të Telekomit, Besa Shatri-Berisha, kishte njoftuar para disa ditësh kabinetin qeveritar, se borxhi i akumuluar ka arritur në 60 milionë euro. Ajo ka thënë se duhet të intervenohet shpejt që të mos rrezikohet falimentimi i kësaj ndërmarrje për 12 muaj.

Shatri-Berisha pati deklaruar se Telekomi i Kosovës ka një numër të madh të punëtorëve, shpenzime të mëdha të qirasë, mbyllja e një borxhi me Z-mobile mbi 26 milionë euro, rreth 11 milionë euro borxhe ndaj furnitorëve, si dhe vazhdimi i humbjeve, ku vetëm për tre muaj kompania ka humbur katër milionë euro.

Kohët e fundit janë shtuar zërat se për të shpëtuar kjo ndërmarrje duhet të ketë edhe ulje të pagave. Në këtë debat u përshinë ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, dhe Federata Sindikale e Pavarur e Postës dhe Telekomit të Kosovës (FSP-PTK), e cila nuk po pranon assesi të ketë ulje të pagave për punëtorët.

Federata Sindikale e Pavarur e Postës dhe Telekomit të Kosovës përmes një reagimi të fundit për medie ka reaguar ndaj deklaratës së ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, se nga muaji i ardhshëm do të ketë ulje të pagave në Telekomin e Kosovës. "Kur të gjithë sot jemi për një Kosovë më të mirë, pa krim dhe korrupsion, ministri pa pikë marre del dhe kërkon që milionat e zhvatur nga krimi të paguhen me pagat e punëtorëve. Ministri gjatë takimit që kemi pasur ka akuzuar mediet se po shpifin për 40 % ulje të pagave, si dhe ministri gjatë gjithë kohës është munduar ta arsyetojë veten se në Z-mobile ka punuar me pagë dhe nuk ka asnjë lidhje me të, ndërsa tash po del dhe vërteton atë që ne e kemi thënë prej fillimit, se është pjesë e krimit, sepse ka qenë drejtor i marketingut dhe shitjes në 'Z-mobile', ku me pozitën që tash ka, dëshiron që ish-shefave ('Z-mobile') t'ua paguajë milionat dhe të shkojë edhe më tej", është thënë në reagimin e kësaj sindikate.

FSP-PTK ka bërë me dije se nuk do ta lejojë uljen e pagave dhe as shkatërrimin e ndërmarrjes. "Përmes, gjoja se investimeve strategjike nga jashtë (me kompani të huaja), ministri po dëshiron ta bëjë 'Z-mobilin' pronar të Telekomit të Kosovës. Këtë strategji të ministrit, e cila është e dëmshme për punëtorët dhe kompaninë, nuk do ta lejojmë të zbatohet dhe, nëse është nevoja, edhe me jetën tonë do ta mbrojmë! FSP-PTK fton punëtorët, shoqërinë civile, deputetët dhe qytetarët e Republikës së Kosovës t'i bashkëngjiten kauzës sonë, sepse po tentohet të fillojë me Telekomin dhe nesër do të zhvaten edhe ndërmarrjet e tjera", është thënë në reagimin e FSP-PTK.

FSP-PTK ua ka bërë me dije institucioneve shtetërore se me mirëqenien dhe djersën e punëtorëve nuk bën të luajnë. "Me shumë sakrificë, mund, djersë e kemi ndërtuar Telekomin, prandaj do ta mbrojmë me të gjitha format. Nëse është nevoja, pa ndihmën e shtetit", është bërë me dije në reagimin e kësaj sindikate.

Pas reagimit të Federatës Sindikale të Pavarur të Postës dhe Telekomit të Kosovës, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka mohuar lajmin se do të ketë ulje të pagave prej 40 % të punëtorëve në Telekomin e Kosovës, por ka lënë mundësinë e hapur se mund të ketë ulje të pagave, por jo në përqindjen që është përfolur. "Ulja e pagave prej 40 % për Telekomin e Kosovës është një spekulim dhe nuk është thënë asnjëherë nga asnjë zyrtar qeveritar. Në asnjë moment nuk e kam përmendur idenë për ulje drastike të pagave siç po flitet në portale. Ajo çfarë kam deklaruar dhe qëndroj prapa, është fakti se Telekomi është në krizë serioze dhe para falimentimit, gjë që është raportuar nga vetë Bordi i Telekomit dhe, si rezultat, do të merren masa për shpëtimin e këtij aseti strategjik për vendin", ka thënë ministri Lluka.

Ai ka bërë me dije se Telekomi ka një humbje prej 15 milionë eurosh në vit dhe duhen të gjenden forma se si të mbulohen këto humbje. "Masat së pari do të fokusohen në ulje të shpenzimeve operative siç janë qiratë, kostot e mirëmbajtjes dhe marketingut. Nëse këto masa nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e të gjitha humbjeve, atëherë do të preken, të fundit, edhe pagat. Në asnjë formë zvogëlimi nuk do të jetë 40 %", është shprehur ai.

Ministri Lluka ka thënë se edhe një javë do ta pranojnë planin e ristrukturimit nga Bordi i Telekomit, ku parashihen edhe masat emergjente që duhen të ndërmerren nga ky bord me aprovim të Qeverisë së Republikës së Kosovës. "Si ministër i Zhvillimit Ekonomik jam i palëkundur për mbrojtjen e interesit publik dhe afarizmit të ndërmarrjeve publike. Telekomi i Kosovës është pronë e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht nuk mund të qëndrojë indiferent ndaj rrezikut që po i kanoset kësaj ndërmarrje e që shpejt edhe mund të falimentojë. Bashkë me kryeministrin, Bordin e Drejtorëve dhe Sindikatën e Punëtorëve, do t'u japim zgjidhje problemeve dhe do ta ndalojmë falimentimin e ndërmarrjes, pavarësisht prej presioneve dhe pakënaqësive", ka thënë Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik.

# Begaj në Gjermani zhvillon takime të shumta për qeverisjen lokale

MALISHEVË, 20 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip, Begaj, me ftesë të humanistit Rudolf Broer, këto ditë është duke qëndruar për vizitë në Gjermani. Krahas kësaj vizite ai është duke u takuar edhe shumë personalitete gjermane të fushës së udhëheqjes lokale, po edhe të biznesit gjerman. Të dielën kryetari Begaj është takuar me mërgimtarët, ndërsa të martën pritet të takohet edhe me kryetarin e Komunës së Sundernit, me të cilën Malisheva ka bashkëpunim të gjatë. Humanisti i njohur Rudolf Broer e ka vlerësuar Malishevën si komunën më të pakorruptuar, po ashtu edhe kryetarin Begaj.





# Rigjenerohet hapësira publike te 'Rruga B'

PRISHTINË, 20 MAJ (ER)- Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se hapësira publike te "Rruga B" tashmë është rigjeneruar plotësisht. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka falënderuar edhe "Meeting of Styles" për vizatimet. "Faleminderit UN Habitat dhe fëmijët që e dizajnuan. Falënderojmë edhe Zyrën e Rigjenerimit Urban për punën e mrekullueshme", ka shkruar Ahmeti.

# PDK-ja kërkon ngritjen e disa shtatoreve në Prizren

PRIZREN, 20 MAJ (ER) - Dega e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prizren ka kërkuar nga kryetari i kësaj komune, Mytaher Haskuka, nisjen e procedurave për ngritjen e disa shtatoreve të komandantëve të UÇK-së, duke përfshirë edhe atë të komandantit legjendar Adem Jashari.

Nëpërmjet një komunikate për medie PDK-ja ka theksuar se kjo parti është vazhduese e vlerave të luftës çlirimtare dhe se angazhohet për promovimin e këtyre vlerave. "Marrë për bazë që vlerat e luftës çlirimtare janë themeli i lirisë dhe i shtetit të Kosovës, PDK-ja është e angazhuar për promovimin e vlerave dhe ruajtjen e përkujdesjen për dëshmorët, veteranët, invalidët dhe për të gjitha kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së. Në përputhje me këto vlera, në përkushtim të ruajtjes së kujtesës sonë historike, për brezat dhe për amanetin e të rënëve, PDK-ja kërkon nga kryetari i Komunës së Prizrenit nisjen e proceduarave për ngritjen e shtatoreve të komandantit legjendar Adem Jashari, komandantit Ekrem Rexha-Drini, komandantit Tahir Sinani, komandantit Hysen Rexhepi, komandantit Agim Shala dhe komandantit Skënder Rexhepi. Roli i tyre në luftën për liri të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte emblematik në betejat e rezistencës kombëtare", është thënë në komunikatën e PDK-së.



Në këtë kontekst, Dega e PDK-së në Prizren ka kërkuar nga kryetari Haskuka që në seancën e radhës të Kuvendit Komunal t'i propozojë lokacionet për vendosjen e këtyre përmendoreve. "Dega e PDK-së në Prizren kërkon nga kryetari i Komunës së Prizrenit që në seancën e radhës të propozohen lokacionet për vendosjen e përmendoreve në bashkëpunim me shoqatat e dala nga lufta që veprojnë në qytetin tonë dhe të njëjtat t'i kthejë për miratim në seancë të Kuvendit Komunal. Grupi i kuvendarëve të PDK-së do të jetë aktiv për përmbushjen e kërkesave për ngritjen e përmendoreve", është thënë në komunikatën e Degës së PDK-së në Prizren.

## Temperaturat këtë javë do të arrijnë deri në 25 gradë celsius

PRISHTINË, 20 MAJ (ER) - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka njoftuar se vendi ynë për pesë ditët e ardhshme do të mbetet nën ndikimin e masave të ajrit me presion të ndryshueshëm atmosferik. "Në këto kushte do të mbajë mot me vranësira të dendura dhe intervale me diell. Vranësirat gjatë ditës nuk do të jenë stabile, do të shoqërohen me reshje shiu dhe vende-vende me shkarkime rrufesh. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 10-12 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihet të lëvizin ndërmjet 22-25 gradë celsius. Do të fryjë erë nga drejtimi i verilindjes dhe jugperëndimit me shpejtësi 1-7m/s", është thënë në njoftimin e IHMK-së.



# DUBRAVA, KY ANKTH I PAHARRUESHËM



Sadik ZEQIRI

Arkivi i kujtesës sime, i paraluftës dhe i gjatëluftës, është shumë i pasur. S'më vjen aspak mirë ta quaj kështu, i pastër, kur brenda tij kam kujtime shumë të këqija e që më lidhen me jetëvdekjen time dhe të shokëve të mi, në ditët tona më të këqija, ato të burgimit në Burgun e Dubravës nga 19-24 maji i vitit 1999. Sa herë vjen maji më vjen edhe ditëlindja ime. Sivjet, në rrethana të tjera, ndryshe nga koha e luftës, festova 45 vjet të shpresës dhe të sakrificës. Meqë doja të ndaja një pjesë të jetës sime me juve, e shkrova këtë shënim të shkurtër për ditët e mia të kaluara në Burgun e Dubravës, në kohën që jua përmenda pak më parë, me qëllim që ta publikoja sot në gazetën "Epoka e re".

Para fillimit të bombardimeve të NATO-s u mblodhën nga të gjitha burgjet e Serbisë të burgosurit shqiptarë dhe u vendosën në Burgun e Dubravës. Ishim rreth 1 000 të burgosur të vendosur në katër pavijone, në C1, C2, B2 dhe në Pavijonin e Pranimit, në kushte shumë të rënda. Në B2 ishte edhe Ukshin Hoti, i cili, çuditërisht, ishte liruar më 16 maj, ditën e diel. Po në të njëjtën ditë ishin liruar edhe dy të burgosur të tjerë. Për fatin e Ukshin Hotit nuk dihet ende asgjë, kurse trupat e të dy të liruarve në të njëjtën kohë me bacë Ukshinin po atë ditë janë gjetur në varrezat e rrethinës së Pejës.

Nëse më lejoni të bëj një shmangie, jua kujtoj se me norma ndërkombëtare asnjë i burgosur nuk lirohet në ditët e fundjavës. Megjithatë, ky rregull nuk ka ekzistuar për regjimin serb, i cili i kishte bërë me përpikëri llogaritë, duke qenë i sigurt se NATO-ja do t'i bombardojë edhe objektet e burgut, meqë NATO-ja kishte informata paraprake se Burgu i Dubravës ishte kthyer në bazë ushtarake dhe pritej që avionët e saj ta bombardonin burgun, pa qenë në dijeni urdhërdhënësit ndërkombëtarë, se aty, qëllimisht, nga politika e Beogradit në Beograd e Beogradit në Kosovë, janë mbledhur një mijë shqiptarë nga të gjitha burgjet e Serbisë, për t'u bërë shkrumb e hi nga granatimet e avionëve. Dhe, ashtu sikurse ishte dhënë lajmi, ashtu nisi dhe u bë: "paramilitarët" kishin liruar burgjet dhe po u bënin vend të burgosurve shqiptarë.

Në Burgun e Dubravës edhe kohë më përpara, por edhe gjatë vitit 1998 kishte të burgosur politikë dhe ordinerë, por me fillimin e luftës, nga muaji qershor, të gjithë të burgosurit i kishin larguar nga aty për në burgjet e Serbisë. Destinacion ishte Burgu i Nishit, i Pozharevacit, CZ i Beogradit, i Sremit, i Leskovcit, i Vranjes etj., ndërsa një numër i të burgosurve ishte edhe në burgun e Pejës, të Gjilanit, të Prishtinës, të Prizrenit, të Mitrovicës etj.

Më 19 maj 1999, ditë mërkurë, kah gjysma e ditës, aeroplanët e NATO-s bombarduan objektet e Burgut të Dubravës. Fillimisht granatuan drejtorinë e burgut si dhe Pavijonin C1, i cili ishte përplot me të burgosur shqiptarë. Pas hedhjes së bombave të para nga avionët e NATO-s, gardianët ikën. Mbetën të mbyllur, në pavijonet C1 dhe B2, të burgosurit shqiptarë. Vetëm të burgosurit në pavijonin C2 kishin një tretman më të veçantë nga ne sepse aty kishte të burgosur kryesisht ordinerë. Ky pavijon pothuaj gjatë gjithë ditës i kishte dyert e hapura. Unë dhe të burgosurit e tjerë që përjetuam krimin në pavijonin C1 filluam t'u kërkojmë ndihmë të burgosurve të tjerë që të na hapnin dyert, sepse kishim frikë se do të digjeshim dhe vriteshim të gjithë brenda, pas shembjes së objektit të burgut i cili ishte qarë. Kështu që, me atë pak forcë që kishim dhe atë panik të madh, filluam t'i thyejmë dyert e qelive. Po në mes të pavijonit C1 bombat e NATO-s veç kishin vrarë katër të burgosur dhe 19 tjerë plagosur. Të burgosurit ordinerë nga C2-shi u organizuan t'i hapnin dyert e dhomave me forcë, me kazma dhe me mjete të tjera. Duke nxjerrë kështu nga gërmadhat të plagosurit dhe të vdekurit, fillimisht në pavijonin C1, pastaj në B2. Kur dolëm në oborr u nisëm drejt daljes kryesore të burgut, duke menduar se tashmë gardianët dhe personeli i burgut kishte ikur. Pasi kemi dalë në oborr, aty në mes të kuzhinës dhe shkollës, ka hyrë prapë personeli i burgut brenda dhe na ka detyruar të futemi nëpër pavijone dhe objekte të cilat nuk ishin të dëmtuara.

Dita e enjte, e datës 20 maj 1999, ishte e qetë. Nuk dëgjoheshin zhurma të avionëve, as hedhje dhe krisje të bombave, as kërcënime të gardianëve. Por, nuk e dinim nëse do ta plaknim ditën!

Dita e premte, e datës 21 maj, ishte ditë lufte. Rreth orës 10:00 të mëngjesit filluan bombardimet e NATO-s në caqet brenda Burgut të Dubravës. U goditën pothuajse të gjitha objektet përbrenda saj, rrjeti elektrik, ujësjellësi, u vranë 19 të burgosur dhe 32 të tjerë u plagosën.

Në natën e 21 dhe 22 majit ne të burgosurit qëndruam jashtë objekteve, në fushën e sportit, pasi mendonim se aty ishte vendi më i sigurt. Morëm me vete batanije dhe gjëra të tjera për t'u mbuluar dhe bëmë gjumë në qiell të hapur.

Më 22 maj, të ditës së shtunë, rreth orës 6:00 të mëngjesit, nga pikat e vrojtimit, të cilat ishin afër me fushën e sportit, na u kërkua nëpërmjet megafonit të zgjohemi dhe të bëhemi rresht. Thoshin se Drejtoria e Burgut ka vendosur të na transferojë në burgjet e tjera sepse nuk ka kushte më në Dubravë. Sapo jemi rreshtuar kanë filluar gjuajtjet nga pikat vrojtuese, me lloje të ndryshme të armëve. Të njëjtit paramilitarë gjuanin granata dore në drejtimin tonë. Na shpërthenin pranë, na vrisnin, na gjymtonin, na plagosnin. Pothuajse të gjithë që kanë qenë në rreshtin e parë janë vrarë. Të burgosurit kanë filluar të ikin, por të gjejnë shpëtim e strehim brenda rrethojës së burgut, në një pjesë më poshtë ngrehinës. Gjatë këtij sulmi nga gardianët dhe të tjerët mbetën të vdekur rreth 80 të burgosur dhe mbi 200 të tjerë u plagosën. Këtë ditë pothuajse gjithë kohës është gjuajtur nga të gjitha pikat e vrojtimit dhe të burgosurit detyroheshin të fshiheshin kudo që u jepej mundësia.

Natën e 22 dhe 23 majit të burgosurit e bënë nëpër pavijone të shkatërruara si dhe në hapësirën e bodrumit të kuzhinës, por kishte të burgosur që ishin futur edhe në puseta, nga dy e tre në një vend, vetëm të shpëtonin.

Në mëngjesin e datës 23 maj 1999 në hapësirat e burgut kishin ardhur shumë paramilitarë dhe të burgosur serbë, të gjithë të armatosur. Filluan t'i hapnin pusetat dhe t'i vritnin të gjithë ata që ishin fshehur në to. Po ashtu, filluan të gjuanin në objektin e kuzhinës ku ishin të strehuar mbi 500 të burgosur dhe lanë të vdekur disa.

Pasi kishin arritur qëllimin për vrasjen e shumë të burgosurve nëpër puseta dhe kudo që i gjenin jashtë, me megafon kërkuan të dalim jashtë dhe të dorëzoheshim. Dhe, kështu vepruam. Dolëm jashtë të gjithë, me duart pas koke dhe u bëmë rresht për dy. Aty para nesh ishte drejtori i burgut dhe disa gardianë, si dhe disa të tjerë të maskuar. Na thanë të shkojmë rresht për dy dhe të futemi në sallën e sportit, pasi ai ishte objekti i vetëm ende i padëmtuar. Ne menduam më të keqen që do të na ndodhte, filluam të përshëndetemi në mes vete. Kur hymë në sallën e sportit, drejtori i burgut u tha disa të burgosurve të tjerë t'i thërrasin të gjithë të burgosurit të cilët ishin të fshehur në objektet e tjera, si dhe t'i sjellin edhe të plagosurit të gjithë në sallë. Ashtu ndodhi. Më pas na u komunikua vendimi që kishte marrë Ministria e Drejtësisë e Serbisë për transferimin tonë në Burgun e Lipjanit sepse, sipas saj, këtu më nuk kishte siguri dhe kushte, por që transferimi do të ndodhte më 24 maj 1999, për arsye se nuk kishte autobus të mjaftueshëm për transferim të menjëhershëm. Pasi dolën gardianët nga hapësirat e burgut dhe na lanë neve tash brenda hapësirave të burgut, të burgosurit filluan t'i identifikojnë të vrarët dhe t'ua shkruajnë emrat dhe ato copa letra t'ua fusin në xhepa të rrobave, sa për identifikim.

Më 24 maj 1999 ndodhi ajo që na u premtua, të gjithë të burgosurve na transferuan në Burgun e Lipjanit. Pas 17 ditësh qëndrimi në këtë burg, pikërisht më 10 qershor 1999 ishte nënshkruar marrëveshja e kapitullimit të Serbisë në Kumanovë. Neve të Burgut të Lipjanit, si dhe të gjithë të burgosurit e tjerë të cilët ishin në burgun e Pejës, të Gjilanit, të Prizrenit, të Mitrovicës, të Prishtinës, na transferojnë në Burgun e Nishit, të Leskovcit, të Sremit, për Beogradit, për Pozharevacit, për Vranjës si pengje të luftës.

Gjatë ditëve 19-24 maj të vitit 1999 në këtë masakër janë vrarë rreth 150 të burgosur shqiptarë si dhe janë plagosur mbi 300 të tjerë.

*(Autori ka mbijetuar në masakrën e serbëve bërë në Burgun e Dubravës)*



## Papa bën thirrje për "pajtim në Tokën e Shenjtë"



VATIKAN, 20 MAJ - Papa Françesku thotë se dialogu dhe pajtimi janë të nevojshëm në Tokën e Shenjtë dhe gjithë Lindjen e Mesme. Ai u tha besimtarëve të dielën në Sheshin "Shën Pjetri" se "shpirtërisht" është bashkuar me lutjet që janë mbajtur të shtunën në Jerusalem, vend i cili, sipas tij, është i shenjtë për hebrenjtë, të krishterët dhe myslimanët.
Gjatë meshës të së dielës, Papa foli për situatën në Gaza dhe u lut që atje të arrihet paqja.
Autoritetet palestineze kanë thënë se më shumë se 110 palestinezë janë vrarë gjatë përleshjeve në mes të kufirit të Rripit të Gazës dhe Izraelit që prej muajit mars. Protesta vdekjeprurëse në kufiri Gaza-Izrael pati edhe në ditën kur ShBA-ja hapi Ambasadën e vet në Jerusalem.

# BE-ja zotohet se do të qëndrojë në marrëveshjen bërthamore

Komisionari evropian për Energji, Miguel Arias Canete, ka thënë se "ne u kemi dërguar mesazh miqve tanë iranianë, se derisa ata vazhdojnë ta respektojnë marrëveshjen, evropianët do t'i përmbushin zotimet e tyre"




BRUKSEL, 20 MAJ - Bashkimi Evropian do të vazhdojë të jetë i përkushtuar për marrëveshjen bërthamore me Iranin përderisa Teherani vazhdon ta respektojë paktin e vitit 2015, që i lehtëson sanksionet në këmbim të frenimit të programit bërthamor. "Ne u kemi dërguar mesazh miqve tanë iranianë, se derisa ata vazhdojnë ta respektojnë marrëveshjen, evropianët do t'i përmbushin zotimet e tyre. Ata kanë thënë të njëjtën gjë", ka thënë komisionari evropian për Energji, Miguel Arias Canete, pasi është takuar në Teheran me shefin për energji bërthamore të Iranit. "Ne do ta vazhdojmë tregtinë tonë, që ka qenë shumë pozitive për ekonominë iraniane", ka thënë Canete në konferencën e përbashkët për media me zëvendëspresidentin iranian Ali Akbar Salehi, që mbikëqyr aktivitetet bërthamore të Teheranit.
Komentet e Canetes vijnë një ditë pasi komisioni evropian propozoi masa për t'i ndihmuar bizneset e BE-së që t'i shmangin sanksionet e ShBA-së ndaj Iranit. Në kundërshtim me ndalesën e vendosur nga ShBA-ja që të mos bëhet biznes me sektorin e naftës së Iranit, Komisioni Evropian ka propozuar t'i lejojë shtetet anëtare të BE-së të bëjnë pagesa për naftën iraniane. Këto pagesa do të bëhen në Bankën Qendrore iraniane, me qëllim që të shmangen dënimet e ShBA-së. Këto masa pritet t'i lejojnë kompanitë amerikane ta shmangin përdorimin e dollarit amerikan dhe sistemin financiar të ShBA-së për të blerë naftë nga Teherani. Kështu, kompanitë do t'i shmangin sanksionet amerikane, që në të kaluarën kanë vështirësuar shitjen e naftës amerikane.
Komisioni ka thënë se ka marrë këto masa pasi ka marrë "dritën e gjelbër" nga liderët e BE-së gjatë samitit në Sofje të Bullgarisë më 17 maj.
Ndërkaq, zëvendëspresidenti iranian, Salehi, gjatë konferencës me komisionarin evropian Canete, është zotuar se shteti i tij do ta shpëtojë marrëveshjen bërthamore, pavarësisht prej tërheqjes së ShBA-së nga pakti dhe rivendosjen e sanksioneve. "Shpresojmë se përpjekjet tona të jetësohen", ka thënë Salehi, duke akuzuar Shtetet e Bashkuara se "nuk janë shtet i besueshëm në marrëveshjet ndërkombëtare".
Pavarësisht prej përpjekjeve të BE-së për t'i mbrojtur bizneset, Total, Allianz dhe disa kompani të tjera evropiane kanë njoftuar se do të tërhiqen nga Irani, nëse sanksionohen nga ShBA-ja. Këtyre kompanive, për këtë qëndrim, u janë bashkuar edhe grupi francez për gaz dhe energji Engie, firma polake PFNiG dhe ajo gjermane DZ Bank.
Në një hap tjetër, Komisioni Evropian gjithashtu ka hequr pengesat për Bankën Evropiane për Investime, që t'i financojë aktivitetet jashtë BE-së, në shtete të tilla si Irani. Kjo lëvizje do t'i lejojë kësaj banke t'i mbështesë investimet e BE-së në Iran.
Komisioni ka bërë thirrje të bëhet më shumë për ta ndihmuar sektorin e energjisë së Iranit dhe kompanitë e vogla dhe të mesme. Investimet e BE-së në Iran, kryesisht nga Gjermania, Franca dhe Italia, kishin arritur në mbi 20 miliardë dollarë më 2016, pasi ishin hequr sanksionet. Këto shtete kryesisht kanë investuar në projekte nga hapësira ajrore deri tek ato të energjisë.

# Modi takon Putinin



NJU DELHI, 20 MAJ - Kryeministri i Indisë, Narendra Modi, është nisur për në Soçi të Rusisë, ku do të takohet me presidentin rus, Vladimir Putin, sot (e hënë), për të biseduar për mënyrat për të forcuar marrëdhëniet mes dy shteteve. Kremlini ka thënë se Modi dhe Putini do të bisedojnë për çështje kyçe të zhvillimit të partneritetit të privilegjuar strategjik dhe në agjendë do të jenë edhe çështjet rajonale dhe ndërkombëtare. "Do të jetë rast i rëndësishëm që dy liderët t'i shkëmbejnë mendimet për çështjet ndërkombëtare dhe për perspektivën afatgjatë që ka në fokus forcimin e partneritetit tonë strategjik", thuhet në një deklaratë të Ministrisë për Çështje të Jashtme të Indisë.
Takimi mes Modit dhe Putinit vjen pasi Putini ka bërë betimin për një mandat tjetër presidencial. Po ashtu, raportet mes Moskës dhe Perëndimit në këto kohë janë në pikën më të ulët që prej përfundimit të Luftës së Ftohtë për shkak të agresionit rus në Ukrainë, rolit të Moskës në luftën shtatëvjeçare siriane, ndërhyrjen në zgjedhjet presidenciale në ShBA dhe helmimin në muajin mars të ish-spiunit rus në Britani.

## Presidenti i Venezuelës kërkon mandat të dytë



KARAKAS, 20 MAJ - Presidenti i Venezuelës, Nicolas Maduro, po kërkon një mandat të dytë gjashtëvjeçar në zgjedhjet e së dielës, që po bojkotohen nga opozita si "kurorëzimi" i një diktatori dhe dënuar nga shumica e komunitetit ndërkombëtar.
55 vjeçari Maduro, një ish-shofer autobusi, pritet të fitojë pavarësisht një krize që po rëndohet me mungesa ushqimore dhe rritje inflacioni, ndërsa prodhimi i naftës ka rënë ndjeshëm në një nga vendet që dikur ka qenë një nga prodhuesit kryesor.
Ish-guvernatori Henri Falcon është rivali kryesor i Maduros, por shanset e tij janë dobësuar nga prania e një kandidati të dytë në garë përballë Maduros, pastori Javier Bertucci.

# Shpirt shqiponje, prapëseprapë...

(Botuar në gazetën "Dita", 17 maj 2018 )



Nga Jeta ZHITIA*

Ndiej mall për pishat. Për pishat e errëta. Për aromën e tyre e cila më kujton fëmijërinë në pyjet e Munih të Gjermanisë dhe në Golemin e Shqipërisë. Ndiej kaq shumë mall për freskinë e tyre.

Këto mendime më pushtojnë të gjithën ndërsa i jap biçikletës përmes shtëpive shumëngjyrëshe të Divjakës. Lule, trëndafila, trëndafila… Sa shumë trëndafila! Ajri më ngop me aromën e drunjve të lulëzuar, të cilën e njoh nga pushimet pranverore në Itali, aty ku çdoherë mendoja: Sa bukur do të ishte të jetoja në një vend me aromë të tillë…

Shtëpitë janë ngjyrë trëndafili, ngjyrë çajmali, ngjyrë lulëkuqe. Të gjitha ngjyra të ndezura që nuk përputhen me natyrën përreth. Por kështu Divjaka krijon një si efekt kutie, krejt si qytet.

I kaloj shtëpitë dhe marr një kthesë. Ah, më në fund, pak teposhtë! Shtrëngoj gjithë muskujt e trupit dhe zbres kodrinën me shpejtësi. Kaloj një kamion, pastaj një makinë. Pa kaluar as dhjetë sekonda, ndodhem prapë në rrafsh. I mbledh këmbët mbi pedale, pastaj i shtyj fort përpara. I shtyj, i mbledh, i shtyj, i mbledh…

Pas pak më shfaqet hyrja mbretërore e Parkut; një rrugë e gjerë me pemë të mëdha. I kaloj ato dhe…. Nuk u besoj dot syve! Një ndjesi hareje ma mbush shpirtin: në fund të rrugës më pret shtrirë si një thesar aromash, një pyll me pisha. Eeeej, me pisha të errëta…

Hijet e freskëta më përqafojnë ndërsa fluturoj mes tyre. Dyrrotaku im i shpejtë e pret ajrin aromatik si me thikë. Drita që derdhet nga sipër zhduket dhe rishfaqet si me magji në duart e mia mbi timon. Majtas, djathtas, majtas, djathtas sërish… Rruga në park vazhdon kthesë pas kthese.

Zogjtë kërcejnë mbi mua, hidhen përpara biçikletës, pastaj ikin në momentin e fundit si të jenë duke e ngacmuar vizitoren e huaj, të cilën të gjithë e shikojnë më sy kuriozë. Kjo tani nuk më pengon më. Nuk ndihem e huaj, vetëm disi e çuditshme. Por ashtu kam qenë gjithmonë. Zogjtë humbasin tiparet njerëzore që ua dhashë në përfytyrimin tim dhe rikthehen të jenë pjesë e natyrës, të paprekur nga thirrja ime ëndërrimtare.

Dëgjoj zhurmën e detit dhe për pak sekonda ndodhem në fillim të një plazhi. Është aq i gjerë sa duket si shkretëtirë. Edhe këtu, zogj. Zogj që rrotullohen në ajër dhe kërcejnë me muzikën e detit. Në largësi dalloj disa silueta kuajsh; një maz vrapon afër tyre. Zbath këpucët, pastaj vrik çorapet… Shkel rërën dhe ndiej kërcitjen e saj në lëkurë. Eci shpejt… Eci derisa arrij buzën e detit. I kaloj kuajt me trupa të fortë dhe të hollë, me ato kokat e ngritura, qafat e tendosura dhe jelet e shprishura nga era.

Një zog buçkalaq ia beh përpara meje. Ecën thuajse ngjitur me tokën, me hapa aq të shpejtë sa nuk i dallohen këmbët. Më bën të qesh sa më dridhet gjithë trupi. Nuk ia heq dot sytë. Ai lëkundet mbi këmbët e padukshme, majtas, djathtas, majtas, derisa shndërrohet në një siluetë të turbullt. Pasi e ka shijuar tokën mjaft, ngrihet edhe ai në ajër dhe fluturon. Fluturon larg…

Si ka mundësi të jetë e tillë kjo tokë?, - pyes veten. Erdha këtu për t'i ikur zhurmës së mendimeve dhe brenda pak orëve kalova në botë të ndryshme. Më në fund ndodhem aty ku mund ta lë shpirtin të lirë dhe të pambrojtur nën qiell të hapur, përballë detit. Në heshtje rigjej të njëjtën pyetje: Çfarë fuqie ka mbi mua kjo tokë në të cilën po shkel?

E mbush grushtin me rërë, era e merr. Ma merr edhe pyetjen. Asnjëherë nuk kam ndjerë që i takoj një toke, apo se një copë tokë më takon mua. Por prapë kur shoh tokën shqipe më duket sikur shoh një pjesë të zemrës sime. E mbush prapë grushtin me rërë…

Si çdo mendim, edhe ky është iluzion dhe nuk përputhet me bindjet e mia kozmopolite. Ia jap erës. Dhe mbaj vetëm ndjenjën e asaj e cila, më në fund, gjeti shtëpinë e vet. Po pate rrënjë, fluturo larg sa të duash. Deri në qiejt që lindin vetëm me mbërritjen tënde…

Mbledh trupin dhe, bashkë me të, mendimet e shpërndara si rëra. Përqendrohem pas çdo hapi, ndërkohë që i afrohem biçikletës. Ulem në shalë dhe rinisem. Klak, klak, klak bëjnë këpucët e mia mbi pedale. Siluetën e pyllit tani e shoh vetëm me cepin e syrit. Era që më mbështjell të gjithën më duket si pëlhurë mëndafshi e parfumuar me vajrat më të shtrenjtë të një bote të cilën e besoja të huaj e të largët, por e gjeta afër, shumë afër.

E lë pyllin pas dhe nxitoj përmes aheve të rrugës mbretërore. Retë gjëmojnë mbi mua. Do të nisë shiu. E bëjmë një garë, - mendoj dhe qesh. Këtu nuk ndiej rrezik, nuk ndiej siklet. Kam ndjerë gjithë jetën, por këtu jo. Këtu bëj garë me retë.

U jap këmbëve fort në pedale. Siluetat e tre djemve në moshë shkollore afrohen shpejt. E kanë zënë gati gjithë rrugën dhe unë ndaloj pedalimin; rrotat vijojnë inercinë me atë zhurmën, klakklakklak…

Shkollarët më shohin dhe pëshpëritin me njëri-tjetrin. Kur u kaloj anash, thërrasin njëzëri "Hello!" me theks anglez. Besojnë se jam e huaj. Nuk jam e huaj, ndoshta jam vetëm pak e çuditshme. Drejtoj shtatin dhe me dorë të ngritur në ajër, thërras me një zë të hareshëm, të cilin mu duk sikur e dëgjoja për herë të parë: "Heeej, jam shqiptare! Përshëndetje!" Ata qeshin. Njëri kërcen në ajër. Të tre tundin duart fort dhe thërrasin: "Ohhhooh! Përshëndetje!". Duket sikur u ngjita entuziazmin tim.

Pedaloj më gjithë forcën time. Shqiptare jam, - u thashë. Por çfarë rëndësie ka? Apo ka? Duhet të dish nga vjen për të mbërritur aty ku ke dëshirë.

Pedaloj fort. Kontrolloj frymëmarrjen. I mbledh këmbët mbi pedale, pastaj i shtyj fort përpara. I shtyj, i mbledh, i shtyj… Zogjtë më shoqërojnë, hidhen përpara rrotës dhe zhduken në çast. Fluturoj bashkë me ta. Tani kam krahë. Shpirt shqiponje, prapëseprapë.

****

**Maj 2018 - Durrës. Jeta Zhitia është një shkrimtare e re shqiptare-gjermane, aktualisht në udhëtim në Shqipëri.*

## JETA ME SHPIRT SHQIPONJE

Falë miqve të mi pata mundësinë që nëpërmjet "Facebook"-ut të lexoj një rrëfim të shkurtër të një artiste që prezantohej si shqiptare-gjermane. Që në rreshtat e parë të një ngjarjeje të rëndomtë, një shëtitje me biçikletë, stili i veçantë i narracionit e bën menjëherë për vete lexuesin, e merr me vete në "biçikletën e saj" për ta shijuar "aromën e luleve, trëndafilave, pemëve të lulëzuar..." për të arritur në fund të rrugës, ku i pret pylli i pishave, që simbolizon në gjuhën artistike të Jetës, "Thesarin e aromave".

Përmes këtij stili të lehtë të përshkrimit artistik, Jeta e bën lexuesin ta ndiejë shpirtin e mbushur plot hare, si të ishte vetë personazhi që përjetoi të gjitha aromat e kësaj shëtitjeje me biçikletë.

Kam bindjen e plotës se me talentin artistike që ka, Jeta Zhitia do të na e zbukurojë jetën me vepra që do të na bëjnë të ndihemi krenarë me këtë shpirt shqiponje. Jetës i sugjeroj të mos zhgënjehet nga konteksti nëpër të cilin kolon shoqëria shqiptare, ku në raste të shpeshta dominojnë pseudovlerat. U takon talentëve të rinj që në rrugëtimin "majtas, djathtas, majtas, djathtas" të ngjiten majave të kulturës dhe artit.

Jeta Zhitia e ka vendin atje lart... ku vetëm shpirti i shqiponjave arrin. **Bardhyl MAHMUTI**

# NATËN NË FSHAT

## Titulli origjinal: A village after dark



KAZUO ISHIGURO

Na ishte njëherë një kohë kur mund të udhëtoja nëpër Angli për javë të tëra pa u lodhur fare - nëse kurrgjë tjetër, udhëtimi disi më mbante. Tani që jam plakur, po çorientohem më lehtë. Dhe në fshat mbërrita pak pasi kishte rënë terri dhe nuk po e njihja fshatin tim të dikurshëm. Nuk po mund të besoja se isha në fshatin e njëjtë ku para shumë kohësh kisha jetuar dhe tani kisha ardhur ta përjetoja ndikimin e tij.

Ama, hiq nuk po njihja, dhe e pashë se po ecja pandalshëm gjarpërueshëm nëpër rrugët e ndiçuara zbehtë, të rrethuara anash me shtëpiza të gurta, karakteristike për rrethin. Rruginat ishin shpesh aq të ngushta saqë nuk mund të çaja përpara pa fërkuar çantën ose bërrylat nëpër njërin a tjetrin mur. Megjithëse me zor, ngulmova të ecja nëpër terrishtë, me shpresë se do të dilja në sheshin e fshatit ku, së paku, mund të orientohesha, ose ta takoja ndonjë fshatar. Dhe kur e pashë se nuk po dilja kurrkund dhe m'u këputën këmbët e lodhura, i thashë vetes se zgjidhja më e mirë ishte të trokisja në derën e ndonjërës prej shtëpizave. Shpresoja se dikujt do t'i kujtohesha.

U ndala para një dere të drunjtë të plasaritur, e cila ishte aq e ulët saqë e dija se duhej ta ulja kokën që të mos i mëshoja po të hyja. Një dritë e dobët po reflektonte skajeve të derës dhe po dëgjoja zëra dhe qeshje brenda. Trokita fort që të sigurohesha se banorët do të më dëgjonin. Por, bash atëherë, dikush prapa shpinës sime ma priti: "Tung".

Ktheva kokën dhe pashë një rioshe rreth të njëzetave, veshur me xhinse copë e çikë dhe me një xhemper të shqyer, teksa po qëndronte në terr jo fort larg meje.

"Pak më parë, ju po ecnit prapa meje", theksoi ajo, "edhe pse të thirra".

"Përnjëmend? Paj, mirë, më vjen keq. Nuk është se doja të tregohesha i pasjellshëm".

"Ju jeni, Fletcher, apo jo?"

"Po", ia ktheva, disi i lajkatuar.

"Wendyt ia mori mendja se ishit ju kur kaluat para shtëpizës sonë. Të gjithë u mahnitëm. Ju ishit një prej atyre, apo jo? Me David Maggisin dhe grupin e shokëve".

"Po", i thashë, "por zor se mund të thuhet se Maggisi ishte më i rëndësishmi. Po habitem që e vlerësoni për të atillë. Kishte edhe figura të tjera, larg më të rëndësishme se ai". Nga goja më dolën një mori emrash dhe isha i interesuar të shihja teksa vajza po lëvizte kokën në shenjë të njohjes. "Por bëhet fjalë për kohën kur ju nuk ishit", i thashë. "Po habitem se si i keni marrë vesh gjithë këto gjëra".

"Nuk janë gjëra të kohës sonë, por ne krejt jemi ekspertë të shoqërisë suaj. Ne dimë shumë më shumë për ta se të vjetrit që ishin këtu atëherë. Wendy ju njeh si paranë e kuqe vetëm prej fotografive".

"Nuk ma ka marrë mendja se të rinjtë qenkan interesuar për ne. Më vjen keq që kalova pranë jush më herët. Por, po e shihni edhe vetë, tani që jam plakur, po çorientohem kur po udhëtoj".

Mezi po e dëgjoja muhabetin e trazuar që zhvillohej prapa derës. Kisha hapur veshët katër dhe mezi po durohesha, megjithëse nuk doja ta këpusja bisedën me vajzën në takimin e papritur.

Ajo më shikoi për një moment, pastaj tha: "Krejt ju të asaj kohe jeni njësoj. David Maggisi erdhi këtu para disa vjetësh. Më '93 ose, mbase, ishte më '94. Edhe ai kështu sillej. Paksa i ftohtë. Mbase kjo ndodh si pasojë e udhëtimeve të shumta".

"Pra, Maggis paska qenë këtu. Sa interesant. E dini, ai nuk ishte prej figurave përnjëmend të rëndësishme. Duhet ta shkulni nga mendja këtë ide. Incidentalisht, mbase mund të më tregonit se kush jeton në shtëpizë". Trokita edhe një herë fort në derë.

"Janë Petersonët", tha rioshja. "Janë derë e vjetër. Atyre mbase u kujtohesh".

"Petersonët", përsërita unë, por ky mbiemër nuk më thoshte asgjë.

"Pse nuk po vini në shtëpizën tonë? Wendy përnjëmend u mahnit. U mahnitëm edhe ne. Është mundësi e vërtetë për ne që aktualisht të flasim me dikë të asaj kohe".

"Do të më pëlqente fort. Por, së pari, do të doja të rehatohesha. Thatë, Petersonët".

Përsëri trokita në derë, këtë here goxha me forcë. Së paku, u hap, duke nxjerrë jashtë ngrohtësi dhe dritën e zbehtë anash deri jashtë në rrugë. Në derën e hyrjes po qëndronte një plak. Po më shikonte me vëmendje para se të më pyeste: "Mos më thuaj se nuk je Fletcher, apo jo?"

"Po, dhe porsa mbërrita në fshat. Ka ditë të tëra që po udhëtoja".

Ai u mendua pak për këtë punë dhe pastaj tha: "Paj mirë, ejani brenda atëherë".

E pashë veten midis një dhome të parregulluar, llugë, plot me dru mali dhe orendi të thyera. Një trung që po ndizej në oxhak ishte burimi i vetëm i dritës, me të cilën mund të shihja një numër figurash të struktura rreth e qark dhomës. Plaku më priu qejfprishur drejt karriges te vatra e zjarrit prej së cilës duket se porsa ishte çuar vetë. Kur u ula, e pashë se nuk mund ta kthej lehtë kokën anash për ta parë ambientin ose të tjerët në dhomë. Por dahu i zjarrit ishte më shumë se i mirëseardhur dhe për një moment, ua ngula sytë flakëve, një dah i këndshëm po ma përshkonte trupin. Zëra po më vinin prapa shpinës, po interesoheshin se a isha shëndosh e mirë, se a kisha ardhur prej së largu, nëse isha i uritur, dhe unë që po mundohesha t'ua ktheja sa më mirë që mundja, megjithëse nuk isha i sigurt nëse përgjigjet e mia ishin të duhurat. Dikur u ndalën pyetjet dhe po më dukej se prania ime po krijonte goxha bezdi, por isha aq mirënjohës për rrënjosinë dhe mundësinë që të pushoja. Fort kisha pasur nevojë të pushoja. Për më tepër, kur kaluan disa minuta në heshtje varri, vendosa t'u adresohesha nikoqirëve të mi me më shumë mirësjellje, dhe e ktheva karrigen time. Pikërisht atëherë, qysh më kishte ndodhur edhe dikur, krejt papritur pata ndjenjën e njohjes së mjedisit. Kisha zgjedhur shtëpizën krejt rastësisht, por tash po shihja se nuk ishte tjetër shtëpizë, pos ajo ku unë kisha kaluar vitet e mia në fshat. Shikimin e hodha përnjëherë në qoshen më të largët - që ishte mbështjellë prej territ - ajo që ishte qoshja ime, ku dikur ishte dysheku im dhe ku kisha kaluar orë të tëra qetësie nëpër libra ose duke biseduar me këdo që vinte vërdallë. Në ditët e verës, dritaret, shpesh edhe dera, lihej hapur që të depërtonte flladi veror. Ato ishin ditët kur shtëpiza rrethohej prej fushave të hapura dhe aty do të vinin edhe zërat e miqve të mi, duke ecur ngadalë nëpër barin e gjatë, duke u përplasur për poezi a filozofi. Këto fragmente të paçmuara të së kaluarës më dolën para syve aq fuqishëm saqë nuk mund t'i largoja sytë prej qoshes sime të vjetër atëherë.

Dikush po më fliste përsëri, mbase po më shtronte një tjetër pyetje, por zor se po ia vëja veshin. Duke u ngritur, ngula shikimin në hijet e qoshes sime dhe mendova se si tani do të mund të bëja një shtrat të ngushtë, të mbuluar me një perde të vjetër, që do të zinte pak a shumë të njëjtën hapësirë ku ndodhej dysheku im. Shtrati dukej se po më ftonte dhe unë sikur isha me dy mendje derisa plaku po fliste diçka.

"Shiko", thashë unë, "e di se ndoshta po e teproj pak. Por, e shihni, kam bërë rrugë të gjatë sot, dhe përnjëmend duhet të shtrihem, t'i mbyll sytë, qoftë edhe vetëm për disa minuta sa të kotem. Pastaj, do të flasim për gjithçka që dëshironi".

Dhe e pashë se figurat në dhomë po më mjegulloheshin. Pastaj një zë tjetër tha krejt pavëmendshëm: "Shtriju atëherë. Kotu pak. Mos na e vërë veshin".

Por unë tashmë kalamendshëm po vazhdoja rrugën drejt qoshes sime. Shtrati dukej si i lagësht dhe po kërciste kur e lëshova trupin këputshëm. Por asnjëherë nuk kisha mbërritur në dhomë si tash pa menduar për udhëtimin. Teksa po rrotullohesha, dëgjova plakun që po thoshte: "Është Fletcheri vetë. O Zot, sa është plakur!"

Një zë gruaje po thoshte: "A po e lëmë të flejë kështu? Mund të zgjohet pas disa orësh dhe pastaj ne do të detyrohemi të rrimë me të zgjuar".

"Lëre të flejë nja një orë a më shumë", tha dikush tjetër. "Nëse edhe pas një ore nuk i del gjumi, do ta zgjojmë ne".

Në këtë pikë, lodhja e kishte bërë të veten. Gjumi ma mori anën.

Nuk ishte gjumë i rehatshëm e i pakëputshëm. Isha disi si as fjetur e as zgjuar, gjithnjë i ndërgjegjshëm për zërat prapa meje në dhomë. Po e dëgjoja mirë një grua që po thoshte: "Nuk e di si më bëri për vete. Ai tani duket si djalë rrugaç".

Në gjendjen as fjetur e as zgjuar, po debatoja me veten nëse këto fjalë më shkonin për shtati mua, apo David Maggisit, ama para se edhe një herë gjumi të më merrte me vete.

Kur më doli herën tjetër, dhoma m'u duk se ishte edhe më e errët, edhe më e ftohtë. Zëra po dëgjoheshin prapa meje me ton më të ulët, por nuk po mund t'ia zija fillin muhabetit. Tani po më vinte keq se kisha fjetur ashtu, dhe për disa çaste mbeta gojëhapur me shikimin kah muri. Por duket se kisha dhënë ndonjë shenjë se isha zgjuar, sepse dëgjova një zë gruaje që këputi muhabetin e përgjithshëm, dhe tha: "Pa shihni, shihni". Dëgjova pëshpëritje, pastaj dëgjova se dikush po vinte kah qoshja ime. Ndjeva një dorë që m'u mbështet me mirësjellje mbi kraharor dhe pashë se ishte një grua në gjunjë para meje. Nuk e ktheva mjaftueshëm trupin sa ta shihja krejt dhomën, por kisha përshtypjen se dora po digjej dhe se fytyra e gruas shihej vetëm në gjysmerrësirë.

"Tani, Fletcher", theksoi ajo, "ka ardhur koha të flasim. Kam pritur qe një kohë të gjatë që të ktheheshe. Shpesh kam menduar për ty".

U ktheva që ta shihja drejt e në sy. Ajo dukej se ishte diku në të dyzetat, madje edhe në atë gjysmëterr po ia shihja pikëllimin e fjetur në sy. Por fytyra e saj nuk po më ngjallte kurrfarë kujtimesh.

"Më vjen keq", i thashë. "Nuk më kujtohet kurrgjë. Por, të lutem, të më falësh nëse jemi takuar ndonjëherë. Këtyre ditëve po e humbas shpesh toruan".

"Fletcher", theksoi ajo, "kur e njihnim njëri-tjetrin, isha rioshe dhe e bukur. Të adhuroja dhe gjithçka që dilte nga goja jote, më dukej si përgjigje. Tani, ja ku je, je kthyer. Ka vite që kam dashur ta them se ma ke shkatërruar jetën".

"Po tregoheni e padrejtë. Po, kam gabuar për shumë gjëra. Por kurrë nuk kam menduar se kam përgjigje për gjithçka. Krejt çfarë kam thënë atëherë, ishte se e kishim detyrë, të gjithë ne, t'i kontribuonim debatit. Ne dinim shumë më shumë për çështjet se njerëzit e rëndomtë këtu. Nëse njerëzit kanë dashur që ne të mos u flisnim, me pretendimin se nuk i dinim shumë punë, atëherë kush do të vepronte? Por kurrë nuk kam pretenduar se kam përgjigjet e duhura. Jo, jo, po tregoheni e padrejtë".

"Fletcher", theksoi ajo, dhe zëri i saj ishte çuditërisht miqësor, "ju bënit dashuri me mua, pak a shumë, sa herë që vija këtu në dhomën tënde. Në këtë qoshe, i bëmë për bukuri të gjitha gjërat e pista. Është e çuditshme të mendoj se si isha mahnitur dikur aq shumë fizikisht me ty. Dhe ja ku je tani, si një kundërmim leckash. Por, më shiko mua, ende jam joshëse. Fytyra më është rrudhur pak, por kur dal në fshat vesh fustane që i kam prerë kastile për t'i nxjerrë linjat e mia. Ende më dëshirojnë shumë burra. Por ty, asnjë grua më nuk do t'i lëshonte sytë. Je një zhelan i qelbur".

"Nuk më kujtohesh", i thashë. "Dhe nuk kam kohë për seks këto ditë. Kam punë të tjera. Punë shumë më të mençura. Në rregull, kam bërë shumë gabime atëherë. Por jam munduar më shumë se të tjerët edhe t'i ndryshoja gjërat. A po e shihni, edhe tani po udhëtoj, kurrë nuk jam ndalur. Kam udhëtuar e udhëtuar në përpjekje t'i zhbëja dëmet që i kam shkaktuar dikur. Kjo është diçka më shumë se mund të thuhet për të tjerët e asaj kohe. Betohem se Maggis, ta zëmë, nuk është përpjekur as deri në gjysmë krahasuar me orvatjet e mia për t'i vënë gjërat në vendin e vet".

Gruaja po m'i përkëdhelte flokët.

"Shikoje veten në çfarë derexhe je katandisur. Dikur t'i përkëdhelja flokët kështu. Shikoja këtë lëmsh të pistë. Jam e sigurt se je kontaminuar me turlifarë parazitësh".

Por ajo vazhdoi të m'i përkëdhelte ngadalë flokët me gishtat e saj nëpër dredhat e mia të papastra. Nuk ndjeja kurrgjë erotike, gjë që, mbase, e dëshironte ajo. Më shumë më dukej kujdes mamaje. Në të vërtetë, për një çast m'u duk se më në fund kisha mbërritur njëfarë ndjenje mbrojtje dhe përsëri po më merrte gjumi. Por ajo u ndal krejt papritur dhe më mëshoi shuplakë të fortë në lule të ballit.

"Pse nuk na bashkohesh neve tani? Ti u kote. Duhet të sqarosh shumëçka". Pasi i tha këto fjalë, u çua dhe iku.

Për herë të parë ktheva trupin mjaftueshëm sa ta shihja krejt

dhomën. Pashë gruan që po kthehej, pastaj duke u ulur në një karrige pranë vatrës. Pastaj pashë tre persona të tjerë që ishin ulur rreth vatrës që po fikej. Njëri prej tyre ishte plaku që ma çeli derën. Dy të tjerët - ulur në një stol prej druri - duket se ishin gra të së njëjtës moshë, si ajo që porsa më foli.

Plaku e pa se isha rrotulluar, dhe u dha shenjë të tjerëve që po i shikoja. Të katërtit duket se po rrinin ulur si të shtangur, pa e çelur gojën. Dhe prej mënyrës se si po rrinin, e mora me mend se kishin diskutuar për mua gjerë e gjatë sa isha fjetur. E derisa po i shikoja, ma merrte mendja se çfarë muhabeti kishin rrokur për mua. Ma hante mendja se kishin kaluar goxha kohë duke shprehur shqetësimin për rioshen që e kisha takuar jashtë dhe për efektin që mund të kishte te shokët dhe shoqet e saj.

"Atyre u lë përshtypje gjithçka", duhet t'u ketë thënë plaku. "Dhe e dëgjova vajzën që po e ftonte t'i vizitonte".

Pa asnjë fije dyshimi, njëra prej grave ulur në stolin e drunjtë, do të ketë thënë: "Por nuk është se mund të bëjë farë sherri tani. Në kohën tonë, na bënte të gjithëve për vete për shkak të sojit që i përkiste - ishin të rinj dhe sharmantë. Por tani kanë kaluar goxha kohë, dhe me atë pamje - atëherë krejt çfarë ka mbetur është çmistifikimi i krejt atyre muhabeteve për kohën e vjetër. Qyshdo qoftë, njerëzit si puna e tij, i kanë ndryshuar shumë qëndrimet. Nuk e dinë as vetë se në çka besojnë".

Plaku do ta lëvizte kokën. "E pashë mënyrën se si vajza ia kishte ngulur sytë katër. Po, ai tani duket si mos më keq. Kur t'i ushqehet pak egoja, kur t'i kthehet energjia e tij rinore, do ta shihni se si rinia do t'i dëgjojë me veshët katër idetë e tij, atë nuk ka kush që do ta ndalë. Do të jetë bash si në rini. Do t'i angazhojë të gjithë në kauzat e tij. Riosheve u pëlqen kështu, kanë mbetur pak gjëra në të cilat ato mund të besojnë tani. More, edhe një bredharak i qelbur, si puna e këtij, mund t'u japë shpresë për një qëllim".

Muhabeti i tyre, gjatë kohës sa unë po kotesha, sigurisht se ishte zhvilluar pak a shumë kështu. Por tani, derisa po i shikoja prej qoshes sime, vazhduan të qëndronin ulur si nën faj, me sytë ngulur në zjarrin e oxhakut. Pas një copë here, brofa në këmbë. Në mënyrë krejt absurde, të katërtit më bishtonin. Prita pak se mos ndonjëri prej tyre do të nxirrte ndonjë fjalë goje. Në fund thashë: "Paj mirë, pak çaste më parë isha në gjumë, por ma mori mend se çka po flisnit. Menjëherë do të marr udhë drejt shtëpizës së të rinjve. Do t'u kallëzoj fije e për pe çfarë duhet të bëjnë me krejt atë energji të tyren, me krejt ato ëndrra, atë gjallëri e shtytje që të arrijnë diçka të mirë e jetëgjatë në këtë botë. Shiheni veten, çfarë tufe njerëzish patetikë. Jini ngujuar në shtëpizë, të frikësuar të ndërmerrni çfarëdo, të lemerisur prej meje, prej Maggisit, prej kujto të asaj kohe. Tuteni të bëni çfarëdo jashtë, vetëm për shkak se dikur bëmë disa gabime. Paj mirë, ata të rinj nuk kanë sharruar në lloç, pavarësisht prej letargjisë që ua kanë predikuar për vite me radhë. Do të flas troç me ta. Do t'i çoj në fund të pusit për gjysmë ore të gjitha përpjekjet tuaja plot keqardhje".

"A nuk ju thashë", iu drejtua plaku grave. "E kam ditur se çka na priste. U munduam ta ndalnim, por çfarë të bëjmë tash?"

Rrapëllova rrugës drejt derës, rroka çantën dhe dola jashtë në terr.

Rioshja ende po rrinte jashtë në vendin që e lashë kur hyra brenda. Dukej se po më priste dhe me lëvizje miratuese koke po më printe rrugës.

Ishte terr burg. U dredhëm nëpër rrugina që zgjateshin ndërmjet shtëpizave. Teksa po kalonim ndanë disa sosh, pashë se dukeshin si mos më keq dhe se po shembeshin. Kisha përshtypjen se do t'i shembja disa prej tyre vetëm po të hidhesha me trupin tim sipër.

Rioshja vazhdonte disa hapa para meje, herë pas here duke kthyer kokën që të më shihte a po e ndiqja. Dikur tha: "Wendy do të shkrihet prej gëzimi. Ajo ishte fort e sigurt se ishit ju kur po ecnit prapa. Tani do të marrë vesh se ia kishte qëlluar, sepse u bë një copë here prej atëherë, dhe tani duhet ta ketë mbledhur grupin. Krejt mezi po presin".

"A i keni bërë pritje të ngjashme edhe David Maggisit?"

"Po, si jo. Përnjëmend u mahnitëm kur ia behu ai".

"Jam i sigurt se ju ka shprehur mirënjohje. Ai gjithnjë ka pasur një ndjenjë teprimi të rëndësisë për veten".

"Wendy thotë se Maggis ishte një prej më interesantëve, porse ju ishit shumë i rëndësishëm. Ajo mendon se ju ishit përnjëmend i rëndësishëm".

Mendova për këtë punë për një çast.

"E dini", thashë unë. "Kam ndërruar mendje për shumë gjëra. Nëse Wendy pret që t'i them të gjitha ato mendime që i shprehja gjatë atyre viteve, paj, ma merr mendja se do të zhgënjehet".

Rioshja duket se nuk dëgjoi, por vazhdoi të printe qëllimshëm përmes grumbullit të shtëpizave.

Pas një copë here, dëgjova hapat që po rrihnin rrugën pas nesh. Fillimisht thashë mos se ishte ndonjë fshatar që po ecte dhe nuk po kthehej. Por pastaj rioshja u ndal nën dritën e ndriçimit publik dhe ktheu kokën prapa. Edhe nuk kisha si të mos ndalesha të shikoja pas krahëve. Një burrë i moshës së mesme ishte nisur drejt nesh. Teksa po afrohej, zgjati dorën dhe ma shtrëngoi timen, megjithëse pa dhënë çehre.

"Pra", tha ai, "paske ardhur".

Pastaj e kuptova se e njihja burrin. Nuk ishim takuar qysh kur ishim dhjetë vjeç. Ishte Roger Button dhe e kisha shok klase dy vjet në Kanada para se familja ime të kthehej në Angli. Roger Buttoni dhe unë nuk është se ishim shokë të ngushtë, por meqë ishte çun i druajtur, dhe meqë edhe ai ishte nga Anglia, më ishte afruar. Nuk e kisha parë e as dëgjuar për të prej asaj kohe. Tani, teksa ia hodha një shikim zhbirues prej këmbëve deri te koka nën dritën e zbehtë, e pashë se jeta nuk ishte treguar bujare me të. Nuk i kishte mbetur asnjë qime në kokë, fytyra i ishte rrudhur dhe krejt trupi i ishte lëshuar. Pavarësisht prej krejt këtyre, nuk kisha asnjë fije dyshimi se para syve kisha shokun e vjetër të klasës.

"Roger", i thashë, "jam rrugës për t'i vizituar miqtë e kësaj zonjushës së re. Janë mbledhur që të më presin. Përndryshe do të vija të të takoja pa menduar dy herë. E kisha në mendje ta bëja, madje edhe para se të bija në gjumë. Po e mendoja vet me vete. Sidoqoftë, natën e vonshme do ta kaloja në shtëpizën e të rinjve. Pastaj, menjëherë do të marr udhë drejt derës së Rogerit".

"Mos ki dert", tha Rogeri Buttoni, derisa ne nisëm të ecnim përsëri. "E di se je shumë i zënë. Por duhej të flisnim. Duhet të flasim për kohën e vjetër. Kur më takuat për herë të fundit - besoj në shkollë - ma merr mendja se isha një djalosh i brishtë. Por, e dini, gjithçka ndryshoi kur i mbusha katërmbëdhjetë vjet, përnjëmend e mblodha veten. U bëra përnjëmend tip lideri. Por ju atëherë u larguat nga Kanadaja. Kam menduar shpesh se çfarë do të ndodhte nëse do të takoheshim kur ishim pesëmbëdhjetë vjet. Të siguroj se ndryshe do t'i kishim raportet".

Derisa po fliste, po ma vërshonin kokën kujtimet. Atëherë, Roger Buttoni më adhuronte si idol, dhe në këmbim, unë e nëpërkëmbja pandërprerë. Sidoqoftë, ndërmjet nesh kishte një mirëkuptim interesant saqë nëpërkëmbja që ia bëja, shkonte në të mirë të tij; si kur pa paralajmërim, e godita papritmas në stomak teksa po luanim, ose kur, teksa po kaloja pranë tij në korridor, ia përdredha fort krahun pas qafës derisa nisi të qante. Ia lëshova zullumin që ta mblidhte veten. Në fakt, efekti kryesor që kishin këto haliti në raportet tona ishte rrekja e tij për t'u kalitur dhe matur me mua. Krejt këto më dolën para syve derisa po e dëgjoja burrin e lodhur që po ecte krah meje.

"Afërmendsh", vazhdoi Roger Buttoni, mbase duke rrokur fillin e mendimeve të mia "se, mbase, po të mos më trajtoje ashtu, kurrë nuk do të bëhesha ai që isha kur i bëra pesëmbëdhjetë vjet. Sidoqoftë, shpesh kam hamendësuar çfarë do të ndodhte nëse do të takoheshim një vit më vonë. Atëherë, përnjëmend isha arrë e fortë për t'u thyer".

Po ecnim përsëri përgjatë rruginave dredharake ndërmjet shtëpizave. Rioshja ende po printe, por tani kishte shpejtuar hapin. Nganjëherë mezi ia dilnim ta shihnim në kthesën e radhës që po merrte dhe thashë me vete se do të na humbte nëse nuk do të hapëronim pak më shpejt edhe ne.

"Natyrisht se sot e kam lëshuar pak veten", po theksonte Roger Buton.

"Por s'kam çare pa e thënë, shok i vjetër, ju jeni katandisur më keq se unë. Krahasuar me ty, po dukem atlet. Nuk e kam për të keq, ama po, qenke bërë një bredharak plakë i palarë, apo jo? Por, e di, edhe një kohë të gjatë pas largimit tuaj, vazhdoja t'ju adhuroja. A do ta bënte këtë Fletcheri? Çfarë do të mendonte Fletcheri nëse do ta merrte vesh? Ah, po. Vetëm kur i mbusha pesëmbëdhjetë vjet apo aty diku, nisa t'i kthehesha asaj kohe dhe të analizoja ty. Pastaj, u acarova fort, ta merr mendja. Madje edhe tani, ende mendoj për këtë punë nganjëherë. I kthehem asaj kohe dhe mendoj. Paj mirë, ai ishte një djalë i keq, e kështu me radhë. Ai atëherë kishte më shumë peshë dhe muskuj se unë, pak më shumë vetëbesim, çfarë djali i keq ishte more ti. Natyrisht, nuk po them se i tillë je edhe sot. Krejt ndryshojmë. Këtë po mundohem ta pranoj".

"A ka kohë të gjatë që jetoni këtu?" - e pyeta, me dëshirën që ta ndërroja muhabetin.

"Po, shtatë vjet, kështu diçka. Natyrisht, njerëzit këtu flasin shumë për ty. Nganjëherë u tregoj për lidhjen e dikurshme. 'Por ai nuk do të më mbajë mend' - u them gjithnjë. 'Pse ta mbajë në mend një djalosh të imët të cilit ia ka ngrënë shpirtin dhe t'i shkojë në mendje ta telefonojë?' Qyshdo qoftë, të rinjtë e këtushëm po flasin përherë e më shumë. Pa dyshim, ata që nuk ju kanë takuar kurrë, piren t'u idealizojnë më së shumti. Ma merr mendja se ke ardhur ta kapitalizosh gjithë këtë. Prapëseprapë, nuk të fajësoj. E kishe për detyrë të mundoheshe dhe të fitoje pak vetërespekt".

Krejt papritur, pamë se para syve kishim një fushë të hapur dhe dytë u ndalëm në vend. E pamë se kishim humbur udhën dhe kishim dalë prej fshati; shtëpiza e fundit ishte një copë të mirë udhe larg. Qysh edhe po druaja, nuk po e shihnim më rioshen; në fakt, e mora vesh se kishte kohë që nuk po e ndiqnim.

Në një moment, doli hëna, dhe pashë se po qëndronim në skajin e një fushe me bar - që shtrihej, ma merr mendja, larg përtej hapësirës që shihej prej ndriçimit të hënës.

Roger Buttoni u kthye vrik kah unë. Çehrja në dritën e hënës i dukej e ëmbël, pothuajse e prekshme.

"Prapëseprapë", tha ai, "është koha që të falim. Nuk duhet të lodhesh hiç për këtë punë. Qysh po e sheh edhe vetë, fundja asgjë nuk të kthehet në jetë. Por, tekefundit, nuk mund të na kërkohet llogari për çfarë kemi bërë kur ishim shumë të rinj".

"Nuk ka dyshim se ke të drejtë", i thashë. Pastaj u ktheva dhe shikova përreth në errësirë. "Por tani nuk jam shumë i sigurt se nga duhet t'ia mbajmë. E sheh, kishte disa të rinj që po prisnin në shtëpizën e tyre. Ata sigurisht se tashmë e kanë mbushur vatrën me dru dhe kanë përgatitur çaj. Dhe kanë pjekur pjekurina shtëpie, mbase edhe pak mish të terur. Dhe në çastin që do të hyja, prirë prej asaj rioshes që po e ndiqnim pak më parë, me siguri se do të shpërthenin në duartrokitje. Do të kishte të qeshura, fytyra për admirim rreth e përqark meje. Ja çfarë po më pret diku. Hiq mua se nuk jam i sigurt se nga duhet t'ia mbaj".

Roger Button shfryu. "Mos ki dert, do ta gjesh atë vend me lehtësi. Përveçse, e dini, ajo rioshja nuk po ju printe si duhej nëse u kishte thënë të shkonit këmbë te shtëpiza e Wendyt. Është shumë larg. Do të duhej të hipnit në autobus. Madje edhe me autobus, është rrugë e gjatë. Rreth dy orë, do të thosha. Por, mos u shqetëso, do të tregoj se ku mund të hipësh në autobus".

Kështu, ai nisi të ecte përsëri rrugës së kthimit kah shtëpizat. Derisa po e ndiqja, mund ta merrja me mend se kishte ecur ora goxha shumë dhe se shoqëruesi im ishte në ankth që të bënte sa më shpejt një sy gjumë. I kaluam disa minuta duke ecur rreth e përqark shtëpizave përsëri, pastaj ai na shpiu në qendër të fshatit. Në fakt, sheshi ishte shumë i vogël dhe zor se e meritonte të quhej shesh; më mirë të thuhej se ishte një lëndinë toke me një shtyllë të vetme ndriçimi. Pak matanë rrezes së dritës kishte disa dyqane, krejt të mbyllura natën. Kishte rënë heshtje varri dhe asgjë nuk po lëvizte. Para se të mbërrinim në zemër të lëndinës, Roger Buttoni u ndal dhe tregoi me shenjë.

"Aty", tha ai. "Nëse rri aty, do të vijë autobusi. Qysh të thashë, nuk është udhëtim i shkurtër. Rreth dy orë. Por, mos u shqetëso. Jam i sigurt se të rinjtë e tu do të të presin. Ata nuk kanë në çka tjetër të besojnë në këto kohë, a po e sheh?"

"Është shumë vonë", thashë. "A je i sigurt se do të vijë autobusi".

"Po more. Natyrisht, mbase duhet të presësh. Por një autobus do të vijë". Pastaj ma rrahu me kujdes kraharorin. "E shoh se është pak e mërzitshme të presësh fikall vetëm këtu por, kur të vijë autobusi, do të gjallërohesh, më beso. Ah, po. Gjithnjë është qejf i madh të udhëtosh me atë autobus. Gjithnjë është përplot me njerëz të hareshëm, që shkrihen së qeshuri duke bërë shaka dhe shikuar për dritare. Kur të hipësh, do të ndihesh rehat, dhe udhëtarët e tjerë do të të bëjnë muhabet, mbase edhe do të të ofrojnë diçka për të ngrënë a pirë. Madje mund t'ia thuhet edhe këngës - varësisht prej shoferit. Disa shoferë kërkojnë të këndohet, disa sosh jo. Mirë, Fletcher, ishte kënaqësi që të pashë".

I shtrënguam duart, pastaj ai u kthye dhe ia mbathi. E shikoja derisa po humbej në terr ndërmjet dy shtëpizave.

Eca deri te lëndina dhe e hodha çantën në tokë para këmbëve. Po dëgjoja mos kishte ndonjë jehonë makine në largësi, por nata ishte absolutisht e qetë. Sidoqoftë, u kënaqa me përshkrimin e autobusit nga ana e Roger Buttonit. Për më tepër, po mendoja për pritjen që më ishte organizuar në fund të udhëtimit tim - me fytyrat admiruese të rinisë - dhe diku thellë brenda meje ndjeja optimizmin e madh.

**(Tregimi është botuar në maj 2001 në revistën amerikane "New Yorker". Për botim në gazetën "Epoka e re" është marrë nga numri i dytë i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia".)**

# Konfirmohet koncerti i Rita Orës dhe Ermal Metës në Tiranë



Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ka konfirmuar nëpërmjet rrjeteve sociale se Rita Ora dhe Ermal Meta po vijnë në Shqipëri. "Ermal Meta dhe Rita Ora këtë herë zbresin në arenën më të bukur të gjithë shqiptarëve, Sheshin 'Skënderbej'. Merr miqtë e familjen dhe shihemi të gjithë në shesh, më 1 dhe 3 qershor!", ka shkruar Veliaj në rrjetin social.

# Palma e artë shkon për 'Hajdutët e dyqaneve'



Filmi japonez "Hajdutët e dyqaneve" arriti të triumfojë në Festivalin e Filmit në Kanë të Francës, duke marrë 'Palmën e Artë'. Regjisori Hirokazu Kore-eda dhe aktorët e filmit tërhoqën trofeun për historinë e pazakontë të një familjeje që jeton duke vjedhur dyqane, derisa një ditë gjen një vogëlushe të dhunuar të cilën e merr në shtëpi.





# Dasma mbretërore

Princi Harry i dha fund beqarisë ditën e shtunë në një ceremoni madhështore të dasmës së tij me Meghan Markle. Vëmendja e gjithë Britanisë, por edhe e botës mbarë, prej ditësh ishte përqendruar te kjo dasmë, që mund të cilësohet dasma e vitit. Me mijëra njerëz iu bashkuan ceremonisë, ndërsa miliona të tjerë e ndoqën atë drejtpërdrejt nëpërmjet transmetimeve televizive.

# Reperi Diddy blen pikturë 21milionë dollarë



Reperi i famshëm amerikan Sean "Diddy" Combs, i njohur më parë edhe si Puff Daddy dhe P Diddy, ka blerë në ankand një pikturë të Kerry James Marshall për 21.1 milionë dollarë. Mendohet se kjo shumë është më e larta në histori për një vepër të një artisti afro-amerikan. Piktura e titulluar "Kohët e kaluara" tregon amerikanët me ngjyrë duke bërë piknik, ski në ujë dhe duke dëgjuar muzikë në parkun e Çikagos. Kjo pikturë është katër metra e gjerë.

E jashtëzakonshme

# Zbulohen lloje të reja merimangash



Më shumë se 20 lloje të reja të merimangave janë gjetur të fshehura në ujërat australiane. Dr. Robert Raven nga Muzeu i Queenslandit ka njoftuar zbulimin e habitshëm të 23 specieve të reja javën që lamë pas. Shkencëtarët u tronditën kur gjetën merimangat gjigante të ujit nga Dolomedes, Ornodolomedes, Megadolomedes, Dendrolycosa dhe gjirin Mangromedes.

FOTO E DITES



Një balerinë bën ushtrime para finales së Kampionatit Botëror të Valleve 2018 në Tianjin. /AFP/

E rrallë

# E fiksuara pas Barbie lyen qenin rozë



Catherina Lauren quhet 'aziatike e vërtetë Barbie' sepse ka një makinë sportive rozë, një tatuazh në kurriz dhe krah me logon e kukullës, një qen pink të quajtur Candy. Ajo është nga Jakarta e Indonezisë dhe fiksimi i saj në jetë është dashuria për ngjyrën rozë dhe pasioni për kukullën Barbie. Ajo tash së fundi e ka lyer edhe qenin me ngjyrë rozë.

## BARSOLETA E DITËS



**Hoxha: Qysh more s'po të vjen marre, po pinë ujë në Ramazan?**

**Fshatari: O baba hoxhë, unë jam katolik.**

**Hoxha: I lumi ti, i lumi!**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Vetem gjate vikendit në ora 15:00**

### "AVENGERS: Infinity War" 3D,



Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlet Johansson, Tom Holland, Zoe Soldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo

**Në ora 18:00**

### "ISLE OF DOGS"



I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson

**Në ora 16:00 dhe 20:00**

### "DEADPOOL 2" (R)




Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

**Regjia:** David Leitch

**Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.**

**Në ora 22:00**

### "I FEEL PRETTY"




Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot duhet t'i merrni gjërat ashtu siç ju vijnë ose ta programoni ditën për të mos pasur surpriza. E rëndësishme është të vendosni herët.



**DEMI**
Partneri po bëhet një pengesë për karrierën tuaj sepse, duke kërkuar praninë tuaj, ju ka bërë të hiqni dorë nga mundësi mjaft të mira.



**BINJAKËT**
Asgjë nuk do t'ju vijë si dhuratë sot. Gjithçka do t'ju duhet ta fitoni vetë me shumë mund dhe punë.



**GAFORRJA**
Shumë persona ju kanë paragjykuar pa parë atë që keni bërë me vepra. Sot do të ndryshojnë mendim dhe do të ketë nga ata që do t'ju kërkojnë falje.



**LUANI**
Një çështje disi bezdisëse do t'jua tërheqë vëmendjen sot. Nuk keni dashur të jeni pjesë e saj, por ju kanë përfshirë pa ju pyetur.



**VIRGJËRESHA**
Familja ju ka përgatitur një surprizë të këndshme që do t'ju kënaqë. Pasditja do të kalojë në shoqëri të mirë dhe biseda interesante.



**PESHORJA**
Kjo kohë ju tërheq çdo gjë që ka të bëjë me kulturën dhe artin. Njohuritë tuaja keni dëshirë t'i thelloni më shumë me kurse e leksione jashtë.



**AKREPI**
Keni mosmarrëveshje me pjesëtarët e familjes dhe kjo gjë nuk po ju lë të qetë. Këtë moment doni të përqendroheni për të zgjidhur një çështje të caktuar.



**SHIGJETARI**
Sot do t'ju vë në siklet një situatë e caktuar. Do t'ju ngelen në mendje për shumë kohë kujtimet e sikletshme që provuat.



**BRICJAPI**
Shoqëria juaj ju ka rezervuar një darkë interesante sot që kishit ditë që e prisnit. Përgatituni të merrni edhe dhurata të këndshme.



**UJORI**
Problemi më i madh sot do të jetë me financat tuaja. Të gjitha fushat e tjera të jetës shkojnë mjaft mirë dhe ju ndiheni të qetë.



**PESHQIT**
Karakteri juaj sot nuk përkon fare me atë çfarë jeni në të vërtetë. Arrogant dhe egoist, sot do të shkaktoni shume hatërmbetje rreth jush.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE | HAUGESUND - ROSENBORG 2 | RANHEIM - MOLDE GG3+ | ASANE - KONGSVINGER 1

# Drita, kampione e Kosovës

Drita e Gjilanit e ka fituar edhe titullin e dytë në histori të saj. Këtë sukses skuadra e Bekim Isufit e arriti pas barazimit ndaj Prishtinës (0-0), në ndeshjen e zhvilluar në Pejë, në praninë e mbi katër mijë shikuesve. Tash Kosovën në gara ndërkombëtare do ta përfaqësojnë Drita në Ligën e Kampionëve dhe Prishtina në Ligën e Evropës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI



PEJË, 20 MAJ - KF Drita nga Gjilani është shpallur kampione e Kosovës në futboll për edicionin 2017/2018. Këtë sukses skuadra gjilanase e arriti pas trembëdhjetë vjetësh, pasi për herë të fundit e kishte arritur në vitin 2003. Skuadra e Dritës këtë edicion e nisi në krye të shtabit teknik me Milaim Zuzakun por, më pas, në vend të Zuzakut u emërua trajner Bekim Isufi, i cili pati një seri pozitive prej 28 ndeshjesh pa humbje.

Në ndeshjen e fundit Drita ishte kundërshtare e Prishtinës dhe për të arritur deri te titulli, përveç barazimit, i mjaftonte edhe humbja me një gol diferencë. Trajneri Bekim Isufi është shprehur i kënaqur me suksesin e arritur si trajner i Dritës. Ky trofe është edhe i pari për Isufin në cilësinë e trajnerit, pasi si futbollist e kishte fituar. "Janë emocionet e para. Vetëm të hënën mund të di se çfarë emocione kemi pasur. Tash na janë përzier pasi ka qenë finale. Mendoj se Drita e ka merituar të shpallet kampione, prandaj jam shumë i kënaqur. Mos të harrojmë një gjë, se të gjitha ekipet kanë bërë konkurrencë dhe ka pasur rivalitet të madh deri në fund", ka thënë Isufi.

Ndeshja në Pejë u zhvillua në një atmosferë të jashtëzakonshme të cilën e krijuan "Plisat" dhe "Intelektualët". Këta të fundit, edhe pse kishin vetëm 100 vende, numri i tyre në qytetin e Pejës ishte shumë i madh. Ndeshja filloi me një ritëm të lartë ku vetëm pas dy minutave lojë Endrit Krasniqi doli përballë portierit Visar Bekaj, por pa mundur ta sjellë ekipin e tij në epërsi. Në minutat në vijim ndeshja kryesisht zhvillohej në mesin e fushës, kurse në minutën e 32-të gjyqtari kryesor Fatmir Tahiri e përjashtoi me karton të kuq Debatik Currin, i cili bëri një ndërhyrje të ashpër ndaj Xhevdet Shabanit.

Katër minuta më vonë Bashiru tenton të befasojë portierin Rexhepi por, pa sukses. Pjesa e parë e ndeshjes përfundoi me rezultat 0-0. Pesë minuta pasi filloi pjesa e dytë, Bozhoviqi rrezikoi portën e skuadrës së Dritës, por kapiteni Ardian Limani e largoi topin nga zona e rreptësisë. Shabani i Dritës në minutën e 62-të, harkoi bukur në zonën e rreptësisë, por asnjë prej lojtarëve nuk u përgjigj për ta dërguar topin në rrjetë. Në minutën e 67 zëvendësuesi Ergyn Ahmeti godet nga largësia, por gjuajtja e tij përfundoi jashtë portës së Rexhepit. Të njëjtën gjë e bëri edhe Xhevdet Shabani i Dritës dy minuta më vonë, por Bekaj ishte në vend. Dhjetë minuta para fundit Visar Bekaj doli edhe një herë shpëtimtar i kryeqytetasve, duke ndalur fillimisht gjuajtjen e Livorekës, më pas edhe të Nezirajt, kurse Kastriot Rexha gjuan jashtë portës. Në minutat shtesë kapiteni i Prishtinës, Armend Dallku, ndëshkohet me karton të kuq, pasi goditi në fytyrë Limanin. Ndeshja përfundoi me rezultat 0-0, kurse kapiteni i Dritës, Ardian Limani, e ngrehi lart trofeun e më të mirit për edicionin 2017/2018.

Trajneri i Prishtinës, Mirel Josa, ka thënë se skuadra e tij është dashur të jetë me e qetë. Ai ka shprehur mendimin se përjashtimi i Currit ka ndikuar shumë në lojën e "bardhekaltërve". "E pata thënë edhe para ndeshjes, duhet të ishim të qetë dhe ta kishim lojën në kontroll. E dimë cilësinë e Dritës, qoftë të qendërsulmuesit, qoftë në krah. Nuk duhet të shkonim me mendimin se duhet ta mbyllnim që në pjesën e parë. Lojtarët e mi u shqetësuan shumë dhe nuk e ruajtën gjakftohtësisë. Na u prishën ekuilibrat me ndëshkimin e Currit. Bëmë ndërrimet e duhura dhe lojtarët që mbetën në fushë e bënë punën mirë, por morali ra nga minuta në minutë, pastaj erdhi ndëshkimi i Dallkut. Drita e meritoi, pasi e administroi lojën më mirë", ka thënë Josa pas ndeshjes.

Ndërsa sulmuesi i kryesor i Dritës, Kastriot Rexha, ka deklaruar: "Është kënaqësi e veçantë që pas 13 vjetësh e rikthyem titullin te Drita. Këta tifozë e kanë merituar, pasi kanë vuajtur shumë vjet për t'iu gëzuar këtij trofeu. Ata kanë ardhur qysh mbrëmë këtu në Pejë dhe e kanë ndjekur ndeshjen nga një hapësirë e papërshtatshme. Për mua ky është titulli i dytë personal, pasi e kam fituar para disa vjetësh edhe me Hysin dhe jam tejet i lumtur".



**STADIUMI "SHAHIN HAXHIUSLAMI" NË PEJË**
Gjyqtarë: Fatmir Tahirin, Edmond Zeqiri, Fatmir Sekiraqa, Selim Isufi.
Kartonë të verdhë: Osmani, Bashiru (Prishtina), Krasniqi, Shabani (Drita)
Kartonë të kuq: Curri, Dallku (Prishtina).
Prishtina: Bekaj, Osmani, Dallku, Bashiru, Jamal, Taipi, Curri, Bozoviq, Hoxha (Ahmeti), Mankenda (Kalid), Januzi (Pevqeli). Trajner: Mirel Josa.
Drita: Rexhepi, Kuka, Gërbeshi, Limani, Leci, Musaj, B.Shabani, Fazliu (Livoreka), Krasniqi (Neziraj), Xh. Shabani, Rexha. Trajner: Bekim Isufi.

## Vëllaznimi dhe Flamurtari në barazh, Besa dhe Vllaznia në Ligën e Parë

Vëllaznimi është skuadra e cila do të luajë në barazh për mbetje në elitë, pasi në ndeshjen e javës së fundit në Vala Superligë që u zhvillua në Gjakovë ka barazuar pa gola me Gjilanin. Ky epilog i këtij takimi i shkoi përshtati skuadrës gjilanase, e cila, falë këtij barazimi, u konfirmua anëtare e elitës edhe për edicionin e ardhshëm. Vëllaznimi të enjten do ta kërkojë mbetjen në elitë në duel me Ferizajn, kurse Flamurtari të mërkurën do të luajë kundër Vushtrrisë.

Tashmë nga Superliga janë përshëndetur Besa dhe Vllaznia e Pozharanit.



### Vala SUPERLIGA

| | |
|---|---|
| Prishtina-Drita | 0-0 |
| Vëllaznimi-Gjilani | 0-0 |
| Drenica-Liria | 1-1 |
| Trepça '89-Vllaznia (P) | 6-1 |
| Flamurtari-Feronikeli | 0-3 |
| Besa-Llapi | 3-4 |

TABELA

| | PIKË |
|---|---|
| 1. Drita | 67 |
| 2. Prishtina | 64 |
| 3. Llapi | 54 |
| 4. Trepça '89 | 53 |
| 5. Feronikeli | 48 |
| 6. Drenica | 48 |
| 7. Liria | 48 |
| 8. Gjilani | 46 |
| 9. Vëllaznimi | 44 |
| 10. Flamurtari | 25 |
| 11. Besa | 22 |
| 12. Vllaznia | 14 |

### LIGA E PARË

| | |
|---|---|
| Kosova (P)-Vushtrria | 2-1 |
| Ballkani-Trepça | 4-1 |
| KEK-u-Ramiz Sadiku | 5-2 |
| Bashkimi (K)-Ferizaj | 6-1 |
| Onix-Dukagjini | 1-2 |
| Hajvalia-Vitia | 2-4 |
| Kika-Fushë Kosova | 5-3 |
| Rahoveci-2 Korriku | 1-1 |

TABELA

| | PIKË |
|---|---|
| 1. KEK-u | 68 |
| 2. Ballkani | 67 |
| 3. Vushtrria | 60 |
| 4. Ferizaj | 51 |
| 5. Onix | 45 |
| 6. Fushë-Kosova | 44 |
| 7. Bashkimi (K) | 40 |
| 8. Vitia | 38 |
| 9. Dukagjini | 37 |
| 10. 2 Korriku | 37 |
| 11. Ramiz Sadiku | 36 |
| 12. Kika | 36 |
| 13. Trepça | 35 |
| 14. Rahoveci | 32 |
| 15. Hajvalia | 26 |
| 16. Kosova (P) | 12 |

## Shkëmbi: Erdha si trajner, po largohem si qytetar



PRIZREN, 20 MAJ - Bledi Shkëmbi nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale ka bërë me dije se është larguar nga detyra e trajnerit të Lirisë. Në një postim në "Instagram" ai ka falënderuar klubin për mundësinë që ia dha që të fitonte përvojën e trajnerit. "Faleminderit për mundësinë që më ofruat për ta drejtuar Lirinë e Prizrenit. E nisa si trajner dhe po largohem si qytetar i një qyteti ku mikpritja dhe respekti më kanë bërë të ndihem i veçantë. Liria ishte një përvojë e mrekullueshme. Për mua nuk është një lamtumirë, por një mirupafshim. Hera e parë nuk harrohet kurrë. Një falënderim për stafin dhe futbollistët e mi me të cilët kam kaluar çaste shumë të bukura si dhe më kanë ndihmuar ta kem më të lehtë këtë përvojë të parë", ka shkruar Shkëmbi.

# Përfaqësueset e KOK-ut, marrëveshje me rëndësi në Botswana



PRISHTINË, 20 MAJ - Përfaqësueset e Komitetit Olimpik të Kosovës, Shqipe Zogiani, Vjollca Krasniqi dhe Rejhan Halili, po qëndrojnë në Gaborone të Botswanës, ku po mbahet Konferenca e 7-të Botërore e Grupit Punues Ndërkombëtar (IWG) për Femrën dhe Sportin.
Përfaqësueset e KOK-ut po zhvillojnë takime të ndryshme me personalitete të larta të konferencës. Ato janë takuar me ish-presidenten e Finlandës, Tarja Halonen, mike e afërt e KOK-ut, me të cilën kanë bashkëbiseduar për Lëvizjen Olimpike në Kosovë.
Të shtunën në mbrëmje është mbajtur edhe "IWG Networking Coctkail", ku përfaqësueset nga Kosova patën rastin të shkëmbejnë ide me drejtoreshën e Bordit të IWG Botswana, Ruth Maphorisa, si dhe me sekretareshën e përgjithshme Game Mothibi, me të cilët u bisedua për bashkëpunimin KOK-IWG Botswana. Takim me rëndësi ishte edhe ai me ministrin e Sportit të Botswanës, Hon Thapelo Olopeng.

# Rihapet beteja për titull në Lindje

OHIO, 20 MAJ - Clevelandi fitoi 116-86 ndaj Bostonit në finalen e tretë të "play-off"-it në Konferencën e Lindjes, duke korrur suksesin e parë dhe rihapur betejën për titullin kampion në këtë kah të NBA-së. Një ndeshje fantastike e skuadrës së Cavaliersit, që u shkëput që në periodën e parë dhe e thelloi diferencën deri në fund. Avantazhi prej 30 pikësh flet qartë për fitoren e lehtë që korri ekipi vendës, ndërkohë që Bostoni zhvilloi një ndeshje të dobët, por miqtë vazhdojnë ta udhëheqin serinë e finaleve, tashmë 2-1. Të pestë titullarët e skuadrës së Clevelandit realizuan mbi 10 pikë, çfarë flet për një lojë të mirë kolektive, ashtu sikurse kishte kërkuar edhe LeBron Jamesi, shënues i 27 pikëve dhe 12 asistimeve. Një punë të mirë bëri edhe stoli pasi që, nga lojtarët që e nisën ndeshjen si zëvendësues, erdhën 42 pikë. Për Bostonin sot mungoi lideri i ekipit, i cili do ta udhëhiqte ekipin në fushë, ndërkohë që Tatumi me 18 pikë ishte shënuesi më i mirë për Celticsin. Edhe ndeshja e radhës do të luhet në fushën e ekipit të Clevelandit.




## SHKURT

### Januzaj kërkohet në Angli dhe Itali

Adnan Januzaj duket se po rigjen shkëlqimin e fillimit të karrierës. Lojtari, i cili zgjodhi Belgjikën, por që është me orgjinë shqiptare, aktualisht luan për Real Sociedadin. Në 34 ndeshje këtë sezon ai arriti t'i realizojë edhe katër gola, megjithëse paraqitjet e tij në fushë ishin të mira. Ofertat për të kanë nisur menjëherë nga Anglia dhe Italia. Januzaj ka shprehur dëshirën se ndihet mirë në Sociedad dhe nuk do të kishte problem po të qëndronte edhe 2 apo 3 sezone të tjera.

### Marquezi triumfon edhe në Francë

Marc Marquez me Hondan e fitoi garën e Çmimit të Madh të Francës në Moto GP, zhvilluar në pistën e La Manshit. Ishte ky suksesi i tretë radhazi për pilotin spanjoll, që konsolidon pozitat në krye të renditjes. Një triumf i merituar i Marquezin, që konfirmon momentin e mirë që po kalon në kampionat, duke përfituar edhe nga gabimet e rivalëve të tij. Në podium, bashkë me Marquezin, u ngjitën edhe italianët Danilo Petrucci (Ducati Pramac) e Valentino Rossi (Yamaha), por që për asnjë moment nuk arritën të duelojnë e rivalizojnë me kampionin e botës në fuqi. Falë këtij triumfi Marquezi shkon në kuotën e 95 pikëve, shkëputur 36 pikë nga Vinales (i dyti) dhe 37 pikë nga Zarco (i treti në renditjen e përgjithshme).

### Galatasaray, kampion i Turqisë

Elita e futbollit turk ka një kampion të ri. Është Galatasaray që rikthen lavdinë pas tre vjetëve, duke përfunduar në pozitën e parë në Superligën e Turqisë. Skuadrës së Fatih Terimit i ka mjaftuar fitorja 0-1 në udhëtim te Goztepes, për ta fituar titullin e 21-të në histori të klubit. Kampionati turk ishte ndër më madhështorët në Evropë, kur deri në xhiron e fundit për titull luftuan katër skuadra.

### Messi e bind Griezmannin t'i bashkohet Barcelonës

Lionel Messi e ka bindur Antoine Griezmannin t'i bashkohet Barcelonës, raporton e përditshmja spanjolle "AS". Atletico Madridi i ka ofruar kontratë me kushte të reja sulmuesit francez, i cili do të fitonte shumë më shumë sikur të vendoste të qëndronte në Atletico. Por, me sa duket, Griezmanni nuk ka mundur ta hedhë poshtë thirrjen e Messit. "AS" sugjeron se Messi i ka thënë Griezmannit se janë duke e pritur me krah hapur në dhomat e zhveshjes së Barcelonës.

### Mourinho: Chelsea nuk e meritonte fitoren

Jose Mourinho mendon se ekipi i tij e meritonte fitoren ndaj Chelseat në finalen e FA Cup. Goli i Eden Hazardit në pjesën e parë vendosi gjithçka në "Wembley", teksa Manchester Unitedi e ka mbyllur sezonin pa asnjë trofe. "Urime Chelseat pasi fitoi, por nuk mendoj se e meritoi. Ata bënë një gol më shumë se ne dhe marrin Kupën, por ne meritonim të fitonim pasi ishim ekipi më i mirë", ka thënë Mourinho. "Nëse ekipi im do të luante siç luajti Chelsea, mund ta imagjinoj reagimin e njerëzve. Ata luajtën në mbrojtje, sidomos pasi kaluan në avantazh. Ata nuk janë budallenj. Pa Lukakun në fushë na mungonte prania dhe ata e dinë mirë këtë gjë. Ishte e vështirë për ne të luanim pa Lukakun ndaj një ekipi që mbron me nëntë lojtarë. Duhet ajo prania", ka deklaruar Mourinho.



Autor: GAZMEND MORINA

BIMË BARISHTORE QË KA VLERA TË MËDHA USHQIMORE | QULL I TRASHË ME MIELL MISRI | QYTET NË ITALI | MJET I MADH LUNDRIMI (shq.) | PJESA E ERRËT E DITËS | ZANORE | PËR MË TEPËR, MADJE | EPOKA E RE | KRYEQYTETI EVROPIAN I MODËS | QË U PËRKET PARAARDHË-SVE TONA | GAZETË QË BOTOHET NË SHQIPËRI

ENË QELQI E RRUMBULLAK-ËT SI SHISHE, PO ME GRYKË TË GJERË E ME KAPAK | AKTORI HOLLIVUDIAN BRED ... / BASHKËT.

FUSHA KU ZHVILLOHET NJË PËRLESHJE | JETËSHKRIM / ZANORE

GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.) | VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE / FUTBOLLISTI ÇEK BAROSH

KRAHINË NË KOSOVË | DRAMË E SANTORIT / E SPËRKAT ME UJË

FILMI I PARË SHQIP | MUZIKANTI PRESHEVA (shq.) / HIT NGA GRUPI "NRG BAND" | BASKETBOLL-ISTI YNË EDMOND

DY BASHKË-TINGËLLORE / DHELPARAK | PORTIERI ILION .... / SHTEGTARE

GOCA | TELEVIZORI KONTROLL-UES | ISMET RAMUSHI | KËNGËTARJA E FAMSHME ..... ROSS / KËNGËTARJA AMERIKANE ... KIM | EDA ZARI / KËNGËTARJA KANADEZE MORISET

EPOKA E RE | KËNGËTARJA ANGLEZE NË FOTO | DËMTIM I NJË MAKINE GJATË KOHËS SË PUNËS | SKENARISTI JETON ........ | JO I VJETËR | EPOKA E RE | KANDËRR E VOGËL ME NGJYRË TË ZEZË / "MOLDE" | ESTONIA / ZANORE

ISH AKTORI PALLASKA | AKTORI ADRIAN / FLETË LETRE PËR DUHAN | BASHKËT. / KOHË E NDARË PËR PUNË | KUNDREJT MJERË / ZENEL OSMANI

KLUB FUTBOLLI ANGLEZ | NOTË MUZIKORE / EMËR MASHKULLI TURK | GJELBËRIMI NË NATYRË / TRAJNERI GJERMAN REHAGEL | ISTRES / SHKRIMTARI .... SHEHU (shq.)

PAJTUESHM-ËRIA (krah.) / BUKURIA, HIJESHIA (krah.) | PËREMËR PRONOR / ZANORE | VARG NJE-RËZISH NË VIJË TË DRE-JTË (shq.) / GRADË USHTARAKE | PERSIA E SOTME

SERË "INDONEZIA" | TANTAL, ELEKTRON / FILOZOF NË GREQINË ANTIKE | ARAP / ERMELINDA MEKSI

KLUB I YNI FUTBOLLI | GOJËTAR / POROSIA E FUNDIT | KUNDËRSH-TAR I BOLSHEVI-ZMIT RUS / DESPOTIK

BASHKËT. | KRYEQYTETI I NJË SHTETI EVRO-AZIATIK / NJË LLOJ SHPATE JO SHUMË E MADHE | SHTET NË AZI (pashq.) | MIMOZA MUSTAFA / QYTET NË KOSOVË | TONI ADAMS / SHUMË E LODHUR, E KËPUTUR

"O" para dy "J" | SUPER MODELJA KANADEZE JESSICA | TËRËSI E MITEVE TË NJË POPULLI / ISH PORTIERI GJERMAN OLIVER ... | EMPLOYER IDENTIFICATI. NUMBER / ISLAM MUSA

LLUKA ANTONINI | NUK KA (bised.) / I FILLUAR | ZANORE | BARAZIM NË SHAH / DOLLAP PËR TË MBAJTUR ZOGJ (shq.) | ZANORE / ISH TRAJNERI YNË I BOKSIT LAH .......

EPOKA E RE | SHUMË I MADH DHE I FUQISHËM / ARTI I VALLEVE ME FIGURA (pashq.) | FUTBOLLISTI KALOU (CHELSEA) / QË LIDHET ME DITËN | LLOJ VEGLE MUZIKORE (sh.shq.)

PEMË E VENDEVE TROPIKALE | AFËRDITA DEMAKU / KËNGËTARJA ... KOÇI | SHEGË / FUTBOLLISTI .... TOURE (MANCHESTER CITY) | REPERJA JONË ... VLORA / NATIONAL UNION TEACHERS

POETI VINCA | FUTBOLLISTI SHQIPTAR OSMANI / OSMAN (perkdh.) | AGJËRIMI (krah.) / RINOR (perkdh.)

"... VEGAS" | XEHETAR / KALJARI, ANKONA | PIRAT / NOTË MUZIKORE

E KËPUTA (krah.) | VEÇIM NGA RRETHI KU JETOJMË / ZANORE | KËNGËTARJA ALTUNA SEJDIU / BASHKËT.

KRYEQYTETI SHQIPTAR | SATIRIK | TËRËSI E VEPRIMEVE TË NJË KULTI FETAR

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: KAVANOZ, PIT, ARENA, ANALE, RARITET, RIM, OPOJA, EMIRA, TANA, ENISI, VASHA, RL, LIKA, DIANA, EZ, MILINGONA, E, SHANI, MORINA, M, LUM, EVERTON, LA, OAZA, I, RAZIA, IM, KORDONI, HIRI, BITUM, TAE, I ZI, LIRIA, ORATOR, ESER, K, ANKARAJA, MM, TA, OJJ, MITOLOGJI, EIN, LLA, SKA, REMIZIM, I, TITANIK, SALOMON, BANANE, AD, NAR, LIL, AGIM, TEFIK, NINIMI, LAS, MINATOR, KUSAR, E NUKA, IZOLIM, TUNA, TIRANA, IRONIK, RIT.

19 vjet pa ty e dashura nënë dhe gjyshe

# SALA MEHIQI-IMERI

(5 maj 1939- 20 maj 1999)



Dje më 20 maj 1999 janë bërë 19 vjet kur paramilitarët serbë të ndanë nga ne e shtrenjta nënë dhe gjyshe!

Ditët, muajit dhe vitet kalojnë, por malli e dhimbja për Ty asnjëherë nuk është shuar. Me dashuri dhe respekt ruajmë kujtimin për Ty e shtrenjta nënë dhe gjyshe.

Nga kjo botë je larguar, por asnjëherë nga mendjet dhe zëmrat tona! Do të kujtojmë çdo herë si nënë dhe gjyshe me virtyte të larta njerëzore.
Kujtimin për ty do ta përcjellim brez pas brezi! Ishe dhe do të mbetesh përherë udhërrëfyesi ynë.

**E përkujtojnë vajzat: Rukija, Zyhrija dhe Ajmanja; djemtë: Rushiti, Beshiri, Hamiti dhe Ragipi si dhe nipat e mbesat nga Llausha e Skenderajt, Mitrovica, Suedia, Danimarka, Finlanda dhe Britania e Madhe.**

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Financave / Ministarstvo Finansija / Ministry of Finance*
*Thesari i Kosovës/Trezor Kosova/Treasury of Kosovo*

### Shpallje e Ankandit të Letrave me Vlerë KV008-18

| | |
|---|---|
| Afati dhe Lloji | 5 Vite– Obligacion Qeveritar |
| Shuma e Ofruar | €20,000,000 |
| Kodi i Instrumentit | KV1212131215 |
| Data e Ankandit | 28.05.2018 |
| Data e Shlyerjes | 29.05.2018 |
| Data e Maturimit | 29.05.2023 |
| Mekanizmi i Çmimit | Çmime të Shumëfishta |

Shënim: Qeveria e Republikës së Kosovës rezervon të drejtën për ri-blerje të kësaj Letre me Vlerë nëpërmjet operacioneve të përcaktuara në Rregulloren për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë.

### Announcement of Securities Auction KV008-18

| | |
|---|---|
| Term and Type | 5 Years – Government Bond |
| Offering Amount | €20,000,000 |
| Instrument Code | KV1212131215 |
| Auction Date | 28.05.2018 |
| Settlement Date | 29.05.2018 |
| Maturity Date | 29.05.2023 |
| Pricing Mechanism | Multiple Price |

Note: The Government of the Republic of Kosovo reserves the right to re-purchase this Issue through operations defined in the Regulation for Primary and Secondary Market of Government Securities.

### Objava Aukcije Hartija od Vrednosti KV008-18

| | |
|---|---|
| Rok i Tip | 5 Godina – Drzavna Obveznice |
| Ponuđeni Iznos | €20,000,000 |
| Instrument kod | KV1212131215 |
| Datum Aukcije | 28.05.2018 |
| Datum Poravnanja | 29.05.2018 |
| Datum Dospeća | 29.05.2023 |
| Mehanizam Cene | Visestruka Cena |

Napomena: Vlada Republike Kosova ima pravo da ponovo otkupi obveznice preko operacija definisanih u Uredbi o Primarnom i Sekundarnom Tržištu Državnih Hartija od Vrednosti.

BQK/CBK Tel.: (038) 222-055 ext. 246

Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Ahmet Ismaili

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/MINISTRIA E SHËNDETËSISË
VLADA KOSOVA/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF HEALTH
**Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale (AKPPM)**
Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva (KALMS)
Kosova Medicines Agency (KMA)

Duke u bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Agjencia e Kosoves per Produkte dhe Pajisje Medicinale shpall këtë:

# K O N K U R S

## 1.Titulli i punës : Një (1) Zyrtar/e për asistimin e punës në Zyren e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Ankesave.

**Referenca :** 02/2018
**Lloji i pozitës :** **Marrëveshje mbi shërbimet e veçanta deri në (6) muaj**
**Orari i punës :** **40 orë në javë**
**Mbikëqyrësi :** **Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM-së**
**Vendi :** **AKPPM-Prishtinë**

**Qëllimi i vendit të punës:**
Të ofrojë përkrahje administrative në Zyrën e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Ankesave.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**
**1.** Sistemimi i dokumentacionit të punës nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv.
**2.**Ndihmon në organizimin e punës në Zyrën e Kryeshefit Ekzekutiv.
**3.** Siguron dokumentacionin e nevojshëm të punës në Zyrën e Kryeshefit Ekzekutiv
**4.** Njofton palët lidhur me vendimet, rekomandimet e Bordit të Ankesave.
**5.** Mbanë proces verbalin e mbledhjes së takimeve të Bordit të Ankesave si dhe evidencën e pjesëmarrjes së anëtarëve të Bordit të Ankesave.
**6.** Përcjelljen e materialit për shqyrtim tek anëtarët e Bordit të Ankesave si dhe njoftimin për kohën e mbajtjes së takimit.
**7.** Pranimi, regjistrimi i ankesave ne librin intern te Bordit te Ankesave.
**8.** Detyra tjera sipas kërkesës së Kryeshefit Ekzekutiv dhe Kryesuesit të Bordit të Ankesave në lidhje me qëllimin e vendit të punës.

**Kualifikimi**
DU+1,ose SHL+2 vite përvojë pune.

**Shkathtësitë**
Njohja e gjuhëve zyrtare.
Njohuri dhe përvojë substanciale.
Aftësi komunikuese, negociuese.
Shkathtësi në planifikim të punës.
Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).

## 2.Titulli i punës : Një (1) Zyrtar/e për menaxhimin e databazes online (barnatari) në modulin e Departamentit të Autorizim Marketingut

**Referenca :** 02/2018
**Lloji i pozitës :** **Marrëveshje mbi shërbimet e veçanta deri në (6) muaj**
**Orari i punës :** **40 orë në javë**
**Mbikëqyrësi :** **Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM-së**
**Vendi :** **AKPPM-Prishtinë**

**Qëllimi i vendit të punës:**
Të ofrojë përkrahje profesionale dhe teknike në menaxhimin e databazës online barantari në modulin e Departamentit të Autorizim Marketingut.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**
**1.** Menaxhimi i të dhënave në sistemin barnatari në modulin e AM-së.
**2.**Përditësimi i të dhënave lidhur me produktet medicinale në sistemin barnatari
**3.** Përgatitja e listave të produkteve medicinale të regjistruara dhe publikimi i tyre.
**4.** Klasifikimi i çertifikatave të AM-së dhe RMA-së dhe URMAS-së
**5.** Ofrimin e ndihmës për zyrtarin e TI-së, dhe ndihmon stafin në zgjedhjen e problemeve profesionale në sistem.
**6.** Mirëmbatja e modulit të DAM-së në sistemin barnatari
**7.** Zgjidhja e problemeve teknike eventuale në DAM.
**8.** Detyra tjera sipas kërkesës së Kryeshefit Ekzekutiv dhe Drejtorit të DAM-së në lidhje me qëllimin e vendit të punës.

**Kualifikimi**
DU + 0, ose SHM + 2 vite përvojë pune.

**Shkathtësitë**
Njohja e gjuhëve zyrtare.
Njohuri dhe përvojë profesionale substanciale ne sisteme elektronike .
Aftësi komunikuese, negociuese.
Shkathtësi në planifikim të punës dhe analizë.
Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).

## 3.Titulli i punës : Një (1) Zyrtar/e për Komunikim

**Referenca :** **02/2018**
**Lloji i pozitës :** **Marrëveshje mbi shërbimet e veçanta deri në (6) muaj**
**Orari i punës :** **40 orë në javë**
**Mbikëqyrësi :** **Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM-së**
**Vendi :** **AKPPM-Prishtinë**

**Qëllimi i vendit të punës:**
Të shërbej si urë lidhëse ndërmejt stafit udhëheqës të AKPPM-së në njërën anë dhe partnerëve bashkëpunuese e mediave në anën tjeter

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**
**1.**Të sherbej si kontakt-përson përgjegjës qe ti informoj me kohë mediat në lidhje me rezultatet e AKPPM-së
**2.**Të kujdeset ne menyrë kreative për imazhin e AKPPM-së
**3.**Të mbaj komunikim te rregullt medial ekzistues si dhe te kontriboj aktivishtnë gjetjen e kontakteve të reja me të gjithë gazetarët dhe mediat të cilat kanë për fokus të trajtojnë çështjet e rendesishme për AKPPM.
**4.**Të monitoroj në baza të rregullta punen dhe ne përputhje rrethanat të asistoj ,propozoj,koordinoj dhe organizoj aktivitetet për paraqitje ne media .
**5.**Të publikoj në baza të përditshme të gjitha informacionet e nderlidhura me AKPPM ueb-faqen e AKPPM-së.
**6.**Të koordonoj organizimin e konferencave dhe seminareve të AKPPM-së
**7.**Të asistoj në hartimin e strategjisë së komunikimit
**8.**Të luaj rol kryesor në hartimin e strategjisë së komunikimit

**Kualifikimi**
Diplomë Universitare: Diplomë univerzitare në Gazetari ,Shkenca Politike, minimum tri (3) vite përvojë pune.

**Shkathtësitë**
Njohja e gjuhëve zyrtare.
Njohuri dhe përvojë substanciale.
Aftësi komunikuese, negociuese.
Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë.
Shkathtësi në organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një grup pune.
Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).

## 4.Titulli i punës : Një (1) Zyrtar/e për Kontrollimin e Përkthimeve

**Referenca :** **02/2018**
**Lloji i pozitës :** **Marrëveshje mbi shërbimet e veçanta deri në (6) muaj**
**Orari i punës :** **40 orë në javë**
**Mbikëqyrësi :** **Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM-së**
**Vendi :** **AKPPM-Prishtinë**

**Qëllimi i vendit të punës:**
Ndihmon departamentin e AutorizimMarketingut në permbushjen e afateve ligjore në lidhje me kontrollimin e përkthimeve në dosjet e AM-së.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**
**1.**Kontrollollimi fletëudhëzimet për pacient.
**2.**Përputhshmëria sipas formës zyrtare të AKPPM-së.
**3.**Përkthimi professional.
**4.**Përputhshmëria e të dhënave me dokumentacionin e dorëzuar.
**5.**Kontorllimi i përmbledhjeve dhe karakteristikave të produktit.
**6.**Kontrollimi i paketimit të jashtëm.
**7.**Kontrollimi i paketimit të brendshëm (Mock-up) .
**8.**Detyra tjera sipas kërkesës së drejtorit të AM-së dhe Kërkesës së Kryeshefit Ekzekutiv në lidhe me qëllimin e vendit të punës.

**Kualifikimi**
DU+2 vite përvojë pune

**Shkathtësitë**
Njohja e gjuhëve zyrtare.
Njohuri dhe përvojë substanciale.
Aftësi komunikuese, negociuese.
Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë.
Shkathtësi në organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një grup pune.
Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).

**Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:**

Formulari për aplikim mund të merret në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Zyra e Personelit, (Adresa:Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000, Prishtinë), ku edhe dorëzohen pas plotësimit. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Personelit në numrin e telefonit: **038/20024243** prej orës **08:00-16:00.**
Formulari zyrtar i konkurrimit duhet të dorëzohet së bashku me dëshminë për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, përvojën e punës, çertifikatën (dëshminë) që s'është nën hetime dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

***"Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjithë komunitetet e Republikës së Kosovës".***
***"Komuniteti jo – shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".***

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrin brenda 3 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati nuk do të shqyrtohen fare.

Kandidatët të cilët hynë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli.

**Afati i konkursit është i hapur 8 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor , webfaqe të AKPPM-së dhe në tabelen e shpalljeve në AKPPM (prej datës:21.05.2018 deri më datën: 28.05.2018 në ora 16:00) .**

Agjencia e Kosoves per Produkte Medicinale
Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000 Prishtine
Tel:+381 ( 0) 38 512-066
Fax:+381 (0) 38 512-243
www.akpm-rks.org

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/MINISTRIA E SHËNDETËSISË
VLADA KOSOVA/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF HEALTH
**Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale (AKPPM)**
Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva (KALMS)
Kosova Medicines Agency (KMA)

Na osnovu Zakona o civilnoj službi Republike Kosovo br. 03/L-149 i Uredbe br. 02/2010 o procedurama zapošljavanja civilnih službenika Republike Kosovo, Kosovska agencija za lekove i medicinska sredstva, objavljuje sledeći:

# K O N K U R S

## 1.Naziv radnog mesta: Jedan (1) Službenik/ica za pomoć pri radu u Kancelariji Izvršnog Direktora i Odbora za žalbe

**Referenca :** **02/2018**
**Vrsta pozicije :** **Sporazum o posebnim uslugama do 6 (šest) meseci**
**Radno vreme :** **40 časova nedeljno**
**Nadređeni :** **Izvršni direktor KALMS-a**
**Mesto :** **KALMS – Priština**

**Svrha radnog mesta:**
Obezbeđuje administrativnu podršku u Kancelariji izvršnog direktora i Odboru za žalbe.

**Zadaci i odgovornosti:**
**1.** Organizuje dokumentaciju o radu Kancelarije izvršnog direktora**.**
**2.** Pomaže u organizaciji rada u Kancelariji izvršnog direktora.
**3.** Obezbeđuje neophodnu dokumentaciju o radu u Kancelariji izvršnog direktora.
**4.** Obaveštava strane u vezi sa odlukama, preporukama Odbora za žalbe.
**5.** Održava zapisnik sa sastanka Odbora za žalbe i evidenciju učešća članova Odbora za žalbe.
**6.** Prenosi materijal za razmatranje članovima Odbora za žalbe i obaveštenje o vremenu održavanja sastanka.
**7.** Prijem, registracija žalbi u internoj knjizi Odbora za žalbe.
**8.** Druge dužnosti na zahtev izvršnog direktora i predsedavajućeg Odbora za žalbe u vezi sa svrhom radnog mesta.

**Kvalifikacija**
DU+1 ili SHL+2 godine radnog iskustva.

**Veštine**
Poznavanje službenih jezika.
Znanje i značajno iskustvo.
Komunikacione veštine, pregovaranje.
Veštine u planiranju rada.
Računarske veštine programskih aplikacija (Word, Excel, Power Point, Access).

## 2. Naziv radnog mesta : Jedan (1) Službenik/ica za upravljanje baze podataka na mreži (lekova) u modulu Departmana za Autorizaciju Marketinga

**Referenca :** **02/2018**
**Vrsta pozicije :** **Sporazum o posebnim uslugama do 6 (šest) meseci**
**Radno vreme :** **40 časova nedeljno**
**Nadređeni :** **Izvršni direktor KALMS-a**
**Vendi :** **KALMS – Priština**

**Svrha radnog mesta:**
Da pruža stručnu i tehničku podršku u upravljanju baze podataka na mreži lakova u modulu Departmana za autorizaciju marketinga.

**Zadaci i odgovornosti:**
**1.** Upravlja podacima u sistemu lekova u modulu AM-a.
**2.** Ažurira podatke o medicinskim proizvodima u sistemu lekova.
**3.** Priprema spiskove registrovanih medicinskih proizvoda i njihovo objavljivanje.
**4.** Klasifikuje sertifikate AM i RMA i URMAS.
**5.** Pruža pomoć IT službeniku i pomaže osoblju u rešavanju stručnih problema u sistemu.
**6.** Održava modul DAM-a u sistemu lekova.
**7.** Rešava eventualne tehničke probleme u DAM-u.
**8.** Drugi zadaci na zahtev izvršnog direktora i direktora DAM-a u vezi sa svrhom radnog mesta.

**Kvalifikacija**
DU + 0, ili SHM + 2 godine radnog iskustva.

**Veštine**
Poznavanje službenih jezika.
Poznavanje i znatno stručno iskustvo u elektronskim sistemima.
Komunikacione veštine, pregovaranje.
Veštine u planiranju rada i analize.
Računarske veštine programskih aplikacija (Word, Excel, Power Point, Access)

## 3. Naziv radnog mesta: Jedan (1) Službenika/ca za Komunikaciju

**Referenca :** **02/2018**
**Vrsta pozicije :** **Sporazum o posebnim uslugama do (6) meseci**
**Radno vreme :** **40 sati nedeljno**
**Nadzornik :** **Izvšni Direktor**
**Mesto :** **KALIMS-Priština**

**Svrha radnog mesta:**
Poslužiti kao most između rukovodećeg osoblja AKPPM sa jedne strane i kooperativnih partnera i medija s druge strane.

**Zadaci i odgovornosti:**
**1.**Poslužiti kao odgovorna kontakt osoba da blagovremeno informiše medije o rezultatima AKPPM-a
**2.**Da se kreativno pobrini o imažu AKPPM-a.
**3.**Da održi redovnu postojeću medijalnu komunikaciju i da aktivno doprinese na pronalaženje novih kontakata sa svim novinarima i medijima koji moraju da se fokusiraju na rješavanje važnih pitanja za AKPPM.
**4.**Za praćenje na redovnoj osnovi rad i u skladu okolnostima da pomogne, predloži, koordinira i organizuje aktivnosti za prezentaciju u medijima.
**5.**Svakodnevno publikovati sve informacije koje se odnose na AKPPM veb stranicu.
**6.**Koordinira organizaciju konferencija i seminara AKPPM-a.
**7.**Pomogne u izradi komunikacijske strategije
**8.**Da igra ključnu ulogu u izradi komunikacijske strategije.

**Kvalifikacije**
Univerzitetska Diploma: univerzitetska diploma u novinarstvu, političke nauke, najmanje tri (3) godine radnog iskustva.

**Veštine**
Znanje službenih jezika.
Znanje i osnovno iskustvo.
Veštine komuniciranja i pregovaranja.
Veštine u odredjivanje ciljeva, radnog planiranja i analize.
Veštine za timsko organizovanje, sposobnost da upravlja sa jednim ili više radnih grupa.
Računarske veštine sa softverskim aplikacijama (Word , Excel, Power Point, Access) .

## 4. Naziv radnog mesta: Jedan (1) Službenika/ca za Kontrolu Prevoda

**Referenca :** **02/2018**
**Vrsta pozicije** : **Sporazum o posebnim uslugama do (6) meseci**
**Radno vreme :** **40 sati nedeljno**
**Nadzornik :** **Izvšni Direktor**
**Mesto :** **KALIMS-Priština**

**Svrha radnog mesta:**
Pomaže odeljenje Marketing Autorizacije u ispunjavanju zakonskih rokova u vezi sa kontrolom prevoditelja u AM zapisnik

**Zadaci i odgovornosti:**
**1.**Kontrola upustva za pacijenta
**2.**Uskladjenost prema službenom obrascu KALMS-a
**3.**Profesionalni prevod
**4.**Usklađenost podataka s dostavljenim dokumentacijom
**5.**Kontrola kompozicije i karakteristike proizvoda
**6.**Kontrola pakovanja
**7.**Kontrola unutrasnjeg pakovanja (Mock-up)
**8.**Ostale dužnosti koje je zatražio Direktor Marketing Autorizacije i zahtjevaglavnog Izvršnog Direktora vezane za svrhe posla.

**Kvalifikacije**
DU+2 godine radnog iskustva.

**Veštine**
Znanje službenih jezika.
Znanje i osnovno iskustvo.
Veštine komuniciranja i pregovaranja.
Veštine u odredjivanje ciljeva, radnog planiranja i analize.
Veštine za timsko organizovanje, sposobnost da upravlja sa jednim ili više radnih grupa.
Računarske veštine sa softverskim aplikacijama (Word , Excel, Power Point, Access) .

**Uzimanje i podnošenje prijava:**
Formular za prijavu se može dobiti u Kosovskoj agenciji za lekove i medicinska sredstva, Kancelarija za osoblje, (Adresa: Bolnički okrug, UKCK, 10000, Priština), gde se i podnose nakon popunjavanja. Za detaljnije informacije možete kontaktirati Kancelariju za osoblje na broju telefona: **038/20024243** od **08:00-16:00** časova**.**
Zvanični formular za prijavu mora da se podnese zajedno sa dokazima o školskoj kvalifikaciji, kursevima koje su pohađali, radnom iskustvu, sertifikatu (dokazom) da nije pod istragom i dve referencije. Korišćenje pogrešnog i nepotpunog obrasca sa potrebnim podacima će se smatrati nevažećim.

***"Civilna služba Republike Kosovo pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo i pozdravlja prijave svih muškaraca i žena iz svih zajednica Republike Kosovo".***
***"Nevećinska zajednica i njihovi članovi imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima državne uprave, centralnoj i lokalnoj upravi, kako je navedeno u članu 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 o državnoj službi Republike Kosovo".***

Prijave poslate poštom, koje sadrži poštanski žig na pošiljci podnetoj poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmotrene ukoliko stignu unutar 3 dana. Prijave koje stignu nakon ovog roka, neće se uopšte razmatrati.

Kandidati koji uđu u uži izbor za intervju, obavestiće se pismeno ili telefonom od strane osoblja u zakonskom roku.

**Rok konkursa je otvoren 8 dana od dana objavljivanja u dnevnim novinama , na internet stranici KALMS-a i na tabli oglasa u KALMS-u (od 21.05.2018. godine do 28.05.2018. godine u 16:00 časova).**

Agjencia e Kosoves per Produkte Medicinale
Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000 Prishtine
Tel:+381 (0) 38 512-066
Fax:+381 (0) 38 512-243
www.akpm-rks.org


Shijo
Pranverën
me...
Jaffa Champion PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa Champion


AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333